

Raporti i ekspertizës: Policët Trena e Dashi janë vetaksidentuar



FLET PËR
"EPOKËN E RE",
TOMË GASHI



EULEX-i ta përfundojë mandatin, Kosova ka kapacitete për çdo sfidë juridike

Avokati Tomë Gashi ka vlerësuar se misioni i EULEX-it nuk ka arritur ta kryejë punën për të cilën ka qëndruar dhjetë vjet në Kosovë. Ai ka thënë se ky mision nuk ka arritur të vendosë sundim të ligjit në veri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se EULEX-i nuk ka kryer kurrfarë roli pozitiv, por e ka lënë Kosovën në gjysmë të rrugës duke qenë mashë e klasës politike. Ai ka pohuar se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin më 14 qershor. Gashi ka vlerësuar se shteti i Kosovës, pavarësisht prej mangësive, ka kapacitete që të ballafaqohet me çdo sfidë juridike. Në këtë intervistë avokati Gashi ka folur edhe për punën e Gjykatës Speciale. Ai ka theksuar se askush përveç kryeprokurorit Jack Smith nuk e di se kur do të ngrihen aktakuzat e para

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**HOTI THOTË SE VENDIMET E
QEVERISË HARADINAJ NUK
JANË LEGJITIME** F. 7

**DHJETËRA IMAMË DO T'U
LIGJËROJNË TË DËNUARVE
KUNDËR TERRORIZMIT** F. 6

**PARKINGU NËNTOKËSOR
NË KRYEQYTET DO TË
KUSHTOJË 12 MILIONË EURO**

F. 11

EKONOMI

**17 MILIONË EURO PËR
REHABILITIMIN E
HEKURUDHËS FUSHË KOSOVË
- MITROVICË** F. 9

**KRYEMINISTRI KËRKON
ANGAZHIM PËR RINGJALLJEN
E TREPÇËS** F. 9

KULTURË

**DRAMA E ANËS DHE
DRAMA JONË** F. 16

EMIN Z. EMINI

SPORT

**PËR TITULL VENDOSËT NË
JAVËN E FUNDIT** F. 18

**DRITA DHE PRISHTINA
PËRFAQËSOJNË KOSOVËN
NË EVROPË** F. 18

Jovanoviqi: Serbia e do veriun për ta njohur pavarësinë e Kosovës

FAQE 3

Lideri i Partisë Demokratike Liberale Serbe, Çedomir Jovanoviqi, ka bërë me dije se Serbia në këmbim të njohjes së pavarësisë së Kosovës e dëshiron pjesën e veriut. Në tryezën "Cila është e ardhmja e marrëdhënieve Kosovë - Serbi", e cila është organizuar nga KDI-ja në Prishtinë, politikani serb që njeh shtetin e Kosovës, ka thënë se këtë synim nuk e thotë dot Serbia sepse e di se është e pamundur. Kurse zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka përsëritur se Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE pa e njohur Kosovën



Gjykata Speciale zgjeron listën edhe me 87 avokatë të tjerë

Dhomat e Specializuara të Kosovës, të njohura si Gjykata Speciale, kanë shtuar në lista emrat edhe të 87 avokatëve mbrojtës, krahas mbrojtësve që ishin pranuar më parë

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi e Borissovi bisedojnë në telefon para mbajtjes së Samitit të BE-së

Prishtinë, 11 maj - Vetëm pak ditë përpara mbajtjes së Samitit të përbashkët historik të BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor në Sofje, presidenti Hashim Thaçi ka zhvilluar sot një bisedë miqësore telefonike me nikoqirin e këtij Samiti, kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borissov, shtet ky që aktualisht kryeson

Presidencën e Bashkimit Evropian. "Së bashku diskutuam sërish për rëndësinë dhe mundësinë e madhe që ofron ky Samit për ta qartësuar rrugën evropiane për Kosovën dhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kushti kryesor për anëtarësim në BE, përveç plotësimit të kriterëve të Kopenhagës, sigurisht se

është mbyllja e çështjeve të hapura ndërmjet të gjitha shteteve në rajonin tonë, të cilat janë të përcaktuara për t'u anëtarësuar në BE", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Thaçi ka theksuar se brenda këtij konteksti, për Kosovën dhe Serbinë, mbetet jetike arritja e marrëveshjes obliguese ligjore për normalizim dhe pajtim.



FSK-ja përfundoi me sukses ushtrimin fushor 'Shqiponja 6'

Forca e Sigurisë së Kosovës, në koordinimin dhe ndërveprimin me agjencitë vendore dhe ushtritë partnere të shteteve të ndryshme, me sukses ka përfunduar ushtrimin e parë fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6". Gjatë dy javëve sa ka zgjatur ky ushtrim morën pjesë gjithsej 1 167 ushtarakë me mbi 147 automjete

shme të marrë detyra të reja. Gjatë vizitës në operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" në Kastriot, Batllavë dhe Koliq, ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së, Rrustem Berisha dhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, i cili tha se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë krenare që kanë punuar përkrah Forcës së Sigurisë së Kosovës, së bashku edhe me gjashtë shtetet e tjera,

për të organizuar këtë ushtrim. "Gjithsej 88 ushtarakë amerikanë janë të përfshirë në ekzekutimin e ushtrimit 'Shqiponja 6' gjatë dy javëve të kaluara. Jam tepër krenar për punën e përmbushur nga ushtarakët tanë bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë", është shprehur Delawie. Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" morën pjesë me njësi ushtarake Garda Kombëtare e Ajovës nga Shtetet

e Bashkuara të Amerikës, Kroacia, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Maqedonia dhe Republika e Shqipërisë, kontingjentet e të cilave u atashuan në njësitet e FSK-së, si dhe Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" gjatë dy javëve sa zgjati ushtrimi morën pjesë gjithsej 1 167 ushtarakë me mbi 147 automjete.

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë të Kosovës dhe shteteve partnere kanë vizituar të premten operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" në Kastriot, Batllavë dhe Koliq. Fillimisht në një takim në objektin e MFSK-së, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka mirëpritur gjeneralët dhe oficerët e shteteve partnere dhe drejtues të agjencive të Kosovës, me ç'rast i ka falënderuar për bashkëpunimin, koordinimin dhe ndërveprimin gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6", ushtrim ky, i pari, si ushtrim ndërkombëtar që është planifikuar dhe ekzekutuar nga FSK-ja së bashku me agjencitë vendore dhe ushtritë partnere të shteteve të ndryshme. Rama e ka vlerësuar lart zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të ushtrimit, duke shprehur admirimin për një bashkëpunim dhe koordinim të të gjithë aktorëve në ushtrim, sidomos ndërveprimin gjatë realizimit dhe ekzekutimit të skenarëve të

ushtrimit. Komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, ka thënë se suksesi i ushtrimit është edhe një dëshmi se kjo forcë është e gat-



Rama replikon me ambasadorin Donald Lu

TIJANË, 11 MAJ - Qëndrimi i kryeministrit Edi Rama lidhur me akuzat e PD-së ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, është bërë të premten shkak për replika mes ambasadorit të ShBA-së në Tiranë, Donald Lu dhe kryeministrit Edi Rama.

Një ditë më parë kryeministri Edi Rama u shpreh nga foltorja e Kuvendit se nëse akuzat e opozitës

do të ishin të vërteta për ministrin, i pari që do të fliste do të ishte ambasadori i ShBA-së, Donald Lu. Lidhur me këtë qëndrim të kreut të Qeverisë, ambasadori amerikan, Donald Lu, ka dhënë këtë mesazh: "Kryeministri duhet të flasë në emrin e vet dhe ne do të flasim në emrin tonë. Ne jemi duke i shqyrtuar pretendimet që janë ngritur në lidhje me vëllanë e

ministrit Xhafaj". Pas kësaj deklarate, të premten ka ardhur edhe replika e kryeministrit Edi Rama me ambasadorin amerikan në Tiranë, Donald Lu. "Patjetër që unë flas për veten time dhe miku ynë Lu flet për veten e vet dhe krejt normalisht, është puna ime të them atë që mendoj kur flas lidhur me të, siç është puna e tij të thotë atë që mendon kur

pyetet lidhur me mua", ka shkruar Rama në "Facebook".

Opozita i akuzon mazhorancën dhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, se ka mbrojtur vëllanë e tij, i dënuar në Itali. Kryeministri Edi Rama deklaroi të enjten në seancën e Kuvendit, se akuzat e PD-së janë avaz i vjetër, ndërsa theksoi se nëse këto akuza për vëllanë e Fatmir Xhafajt do të



kishin përgjegjësi për ministrin, të parët që do të flisnin do të ishin ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu dhe përfaqësuesja e delegacionit të BE-së.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur tryezën
"Cila është e ardhmja e marrëdhënieve Kosovë - Serbi"

Jovanoviqi: Serbia e do veriun për ta njohur pavarësinë e Kosovës

Lideri i Partisë Demokratike Liberale Serbe, Çedomir Jovanoviqi, ka bërë me dije se Serbia në këmbim të njohjes së pavarësisë së Kosovës e dëshiron pjesën e veriut. Në tryezën "Cila është e ardhmja e marrëdhënieve Kosovë - Serbi", e cila është organizuar nga KDI-ja në Prishtinë, politikani serb që njeh shtetin e Kosovës, ka thënë se këtë synim nuk e thotë dot Serbia sepse e di se është e pamundur. Kurse zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka përsëritur se Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE pa e njohur Kosovën

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 11 MAJ - Lideri i Partisë Demokratike Liberale Serbe, Çedomir Jovanoviqi, në Prishtinë ka treguar për qëllimin që Serbia ka në raport me Kosovën. Në tryezën "Cila është e ardhmja e marrëdhënieve Kosovë-Serbi", të organizuar nga KDI, në të cilën ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, politikani i vetëm serb që pranon Republikën e Kosovës, ka thënë se Serbia mund të pretendojë veriun e Kosovës në këmbim të njohjes së pavarësisë, por nuk e thotë dot. "Ne marrim pjesë në dialog dhe Prishtina është e qartë se çfarë dëshiron.

Por, çfarë dëshiron Beogradi? Beogradi dëshiron diçka, por këtë nuk mund ta thotë pasi që kjo është e pamundur. Duhet të ulemi këtu para jush dhe të themi, këtë duam, veriun e Kosovës. Atje ka kohë që nuk po bëhet jetë normale dhe duhet thënë na e jepni veriun e Kosovës që ne ta pranojmë pavarësinë e shtetit tuaj", ka thënë Jovanoviqi. Ai është shprehur kundër ndonjë marrëveshje që do të nënkuptonte ndarje të brendshme në shoqërinë e Kosovës. Jovanoviqi ka thënë se e mban këtë qëndrim ngaqë e di se çfarë pasojash do të ketë një gjë e tillë. Zyrtari serb ka thënë se pranimi i ndërsjellë, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nuk është real, pavarësisht

se do të ishte zgjidhja e dëshirueshme. Duke folur për procesin e dialogut, Jovanoviqi ka thënë se kohët e fundit ka ndryshuar retorika e Beogradit. "Vërej se është ndërruar retorika, vërej se për kryetarin Vuçiq nuk është sot problem të thotë se është dëgjuar me kryetarin Thaçi etj., por më shqetëson gjendja e përgjithshme në të cilën ndodhet shoqëria ime, e cila nuk është e aftë ta kuptojë realitetin, njëjtë sikurse në të kaluarën, prandaj nuk besoj në marrëveshjet pas të cilave qëndrojnë individët", është shprehur ai, duke shtuar se politika në Beograd duhet të udhëhiqet në një mënyrë krejt ndryshe. Sipas tij, për Serbinë duhet të jetë e mjaftueshme që serbët që jetojnë në Kosovë të ndihen si në shtetin e vet. "Unë mendoj se ne në radhë të parë duhet ta kemi parasysh idenë e paqes, mirëkuptimit reciprok dhe aftësisë që në një mënyrë ndryshe t'i zgjidhim problemet tona. Shpresoj se kjo mënyrë do të vijë në shprehje gjatë bisedimeve që ndodhen para nesh", është shprehur Jovanoviqi. Ndërsa zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se në dialogun me Serbinë janë arritur shumë

marrëveshje, por në zbatimin e tyre është bërë pak. "Marrëveshja për Asociacionin e cila është arritur në vitin 2013 pjesërisht, por e cila është përmbyllur në vitin 2015, është një kompromis i madh. Është një kompromis i dhimbshëm për Kosovën, është një asht i madh që do të duhej ta përpijë Kosova dhe kjo temë jo vetëm se i ka ndarë partitë për atë se si duhet të themelohet, kur do të duhej të themelohej, cilat do të ishin kompetencat, karakteri i tij, por do të jetë një temë që do ta dallojë jetën tonë politike edhe gjatë muajve të ardhshëm", ka thënë Hoxhaj. Ai ka folur edhe për pritjet që ka Kosova nga faza finale e dialogut me Serbinë. "Kur flasim për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi ne mendojmë se pritja e vetme që ka Kosova është njohja e ndërsjellë. Faza në të cilën po hyjmë është një fazë e vështirë, do të jetë një fazë interesante dhe do të varet se çfarë qëndrimi do të ndjekim ne në Kosovë dhe do të varet çfarë qëndrimi do të ndjekë Serbia, por do të varet shumë edhe nga konteksti rajonal dhe ndërkombëtar", ka thënë Hoxhaj. Më tej, ai ka shtuar se nuk duhet të mendohet që Serbia të jetë garanci që Kosova të anëtarësohet në OKB,

ashtu siç kohët e fundit herë pas here po flet presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Sipas Hoxhaj, ky proces nuk është në dorë të Serbisë. "Ajo çfarë ka në dorë Serbia është njohja e ndërsjellë, ndërsa anëtarësimi i Kosovës në OKB është letër që të tjerët e kanë në dorë", është shprehur Hoxhaj. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka vlerësuar se Serbia nuk mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian pa e njohur Kosovën. Kjo, sipas tij, jo për shkak të dëshirave të Kosovës, po për shkak që BE-ja ka një situatë ku nuk mund të pranojë shtete që nuk kanë marrëdhënie diplomatike dhe që nuk kanë njohje të ndërsjellë. Në hapje të kësaj tryeze ka folur edhe drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, i cili ka theksuar se procesi për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po shkon drejt mbylljes. Sipas tij, ky proces ka pasur vështirësitë e veta, mungesë të transparencës, si dhe ka prodhuar efekte të cilat nuk kanë qenë çdoherë pozitive, siç është mungesa e zbatimit të marrëveshjeve. Ky diskutim u organizua në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" që përkrahët nga Ambasada e Zvicrës në Prishtinë.



Raporti i ekspertizës: Policët Trena e Dashi ishin vetaksidentuar



PRISHTINË, 11 MAJ - Policët Armend Trena dhe Malsor Dashi, të cilët kishin rënë më 28 prill në lumin Lepenc, teksa po udhëtonin me veturën zyrtare në magjistralen Hani i Elezit - Kaçanik, sipas raportit të

ekspertizës së komunikacionit, janë vetaksidentuar. Kështu ka thënë të premten kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Shukri Jashari. Sipas tij, autopsia e trupave që u gjetën javën e kaluar në lumin Lepenc

ende nuk është publikuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Autopsia pritet të kryhet deri të hënën. Trupi i Malësor Dashit u gjet pesë kilometra nga vendi i ngjarjes, pas gjashtë ditësh, ku dyshohej fillimisht se kishte

rënë vetura. Ndërsa trupi i Armend Trenës u gjet në ditën e dhjetë të kërkimeve, gjashtë kilometra nga vendi i ngjarjes, në lumin Lepenc, më saktësisht në vendin e quajtur "Kulla me Çeshme".

Flet për "Epokën e re", Tomë Gashi

EULEX-i ta përfundojë mandatin, Kosova

Avokati Tomë Gashi ka vlerësuar se misioni i EULEX-it nuk ka arritur ta kryejë punën për të cilën ka qëndruar dhjetë vjet në Kosovë. Ai ka thënë se ky mision nuk ka arritur të vendosë sundim të ligjit në veri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka thënë se EULEX-i nuk ka kryer kurrfarë roli pozitiv, por e ka lënë Kosovën në gjysmë të rrugës duke qenë mashë e klasës politike. Ai ka pohuar se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin më 14 qershor. Gashi ka vlerësuar se shteti i Kosovës, pavarësisht prej mangësive, ka kapacitete që të ballafaqohet me çdo sfidë juridike. Në këtë intervistë avokati Gashi ka folur edhe për punën e Gjykatës Speciale. Ai ka theksuar se askush përveç kryeprokurorit Jack Smith nuk e di se kur do të ngrihen aktakuzat e para

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 MAJ - Avokati Tomë Gashi ka thënë të premten se ngrehja e aktakuzave të para të Gjykatës Speciale është në duart e kryeprokurorit Jack Smith. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se askush saktë përveç kryeprokurorit Jack Smith nuk e di se kur do të ngrihen aktakuzat e para. Megjithatë, sipas Gashit, kryeprokurori Smith ka përvojë juridike në këtë punë dhe nuk i nevojitet aspak kohë shtesë për t'u familjarizuar me lëndë ngaqë ai nuk do të kryejë hetime të reja, por do t'i vazhdojë të njëjtat lëndë aty ku kanë arritur prokurorët e rasteve në Hagë. Ai ka bërë me dije se nuk ka aplikuar fare për akreditim në Hagë në Gjykatën Speciale, sepse nuk dëshiron të punojë si avokat i caktuar zyrtarisht nga gjykata, por dëshiron t'i mbrojë ata që përzgjedhin ekipin tij. Gashi ka treguar se ekipi i tij është i interesuar t'ua ofrojë shërbimet më të mira vetëm atyre që kanë mundësi financiare t'i paguajnë ato. Avokati Gashi ka folur edhe për punën e EULEX-it, duke thënë se ky mision nuk ka arritur të


vendosë sundim të ligjit në veri të Kosovës. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se EULEX-i nuk ka kryer kurrfarë roli pozitiv, por e ka lënë Kosovën në gjysmë të rrugës, duke qenë mashë e klasës politike.

Gashi ka deklaruar se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin më 14 qershor. Sipas tij, 14 qershori duhet të jetë ditë e shënuar në të cilën duhet festuar për largimin e EULEX-it. Avokati Gashi ka vlerësuar se


shteti i Kosovës, pavarësisht prej mangësive, ka kapacitete të ballafaqohet me çdo sfidë juridike që i paraqitet.

"Epoka e re": Z. Gashi, gjatë kësaj jave është emëruar krye-

prokurori i Dhomave të Specializuara të Kosovës, e njohur në opinionin tonë si Gjykata Speciale. Jack Smith, pas emërimit, ka bërë me dije se është i gatshëm t'i çojë përpara hetimet. Kur prisni ta



Haradinaj: Kosova e përkushtuar për sundim të ligjit



PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim shefen e EULEX-it, Alexandra Papadopoulou, nga e cila është informuar për rrjedhën e përfundimit të mandatit të EULEX-it dhe për procesin e shkëmbimit të letrave në mes të presidentit dhe përfaqësues së lartë të BE-së, Federica Mogherini. Haradinaj ka thënë se edhe pas përfundimit të mandatit, EULEX-i në rolin këshillëdhënës do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me

Qeverinë për fuqizimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit. Haradinaj ka theksuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për rrugën e saj për sundimin e ligjit. Shefja e EULEX-it ka theksuar se edhe pas përfundimit të mandatit, EULEX-i në rolin këshillëdhënës do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë për fuqizimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit. Pas 15 qershorit të këtij viti, mandati i EULEX-it në Kosovë do të jetë këshillëdhënës.

ka kapacitete për çdo sfidë juridike



këtë punë dhe nuk i nevojitet aspak kohë shtesë për t'u familjarizuar me lëndët ngaqë ai nuk do të kryejë hetime të reja, por do t'i vazhdojë të njëjtat lëndë aty ku kanë arritur prokurorët e rasteve në Hagë. Është e vërtetë se Jack Smith është kryeprokuror, por lëndët janë hetuar në vazhdimësi që nga viti 2014 e deri më sot.

"Epoka e re": Ju personalisht do të jeni i angazhuar në Gjykatën Speciale?
Gashi: Unë nuk kam aplikuar fare për akreditim në Hagë në

Gjykatën Speciale sepse nuk dua të punoj si avokat i caktuar zyrtarisht nga gjykata, por dua t'i mbroj ata që përzgjedhin ekipin tim së bashku me dy avokatë amerikanë, Gregor Gay Smith dhe Calin Rohan. Ne jemi të interesuar t'ua ofrojmë shërbimet tona më të mira vetëm atyre që kanë mundësi financiare t'i paguajnë ato, sepse kemi qenë të angazhuar në shumë raste në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë për ish-Jugosllavinë dhe në gjykata të tjera ndërkombëtare dhe nuk jemi të interesuar të qëndrojmë

në Hagë pa klientë kredibilë.

"Epoka e re": Z. Gashi, a mendoni se edhe pas 14 qershorit, kur do t'i përfundojë mandati EULEX-it, Kosova do të ketë nevojë për këtë mision qoftë në këtë format qoftë në një tjetër?

Gashi: EULEX-i është dashur ta kryejë punën për sundimin e ligjit sidomos në veriun e Kosovës, por kjo nuk ka ndodhur. Ky mision nuk ka kryer kurrfarë roli pozitiv, por na ka lënë në gjysmë të rrugës duke qenë mashë e politikës së Kosovës.

Prandaj, EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin më 14 qershor. Unë besoj se më 14 qershor duhet të festojmë për largimin e EULEX-it dhe kjo ditë duhet të jetë e shënuar.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh përvojën tuaj në këtë fushë, besoni se drejtësia e Kosovës ka kapacitete t'i kryejë punët pas largimit të EULEX-it?

Gashi: Ne si shtet i Kosovës kemi kapacitete të merremi me çdo sfidë juridike që na paraqitet.

Gjykata Speciale zgjeron listën edhe me 87 avokatë të tjerë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 11 MAJ - Dhomat e Specializuara të Kosovës, të njohura si Gjykata Speciale, kanë shtuar në lista emrat edhe të 87 avokatëve mbrojtës, krahas mbrojtësve që ishin pranuar më parë. Në një komunikatë për medie të kësaj gjykate është bërë me dije se regjistrimi në këto lista bën që këta avokatë ta kenë mundësinë të zgjidhen për t'u paraqitur para Dhomave të

Specializuara të Kosovës për të përfaqësuar të dyshuar, të akuzuar, një grup viktimash, apo çdo person tjetër që ka të drejtën e përfaqësimit ligjor në bazë të Ligjit për krijimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të Direktivës për Mbrojtësit. Listat e publikuara përmbajnë emrat e 87 profesionistëve të fushës së drejtësisë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera. Me këtë rast, kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës,

Ekaterina Trendafilova, ka përgëzuar të gjithë kandidatët dhe kandidatet, duke thënë se kriteret e rrepta për pranim në këto lista janë garanci që të pandehurit dhe viktimat do ta kenë mundësinë të përfaqësohen në mënyrë profesionale dhe efektive para Dhomave të Specializuara Kosovës. Ajo ka thënë se kjo do të kontribuojë më tej për forcimin e integritetit të administrimit të drejtësisë nga ana e Dhomave të Specializuara. Që nga nëntori i vitit 2017 kur

filloi ky proces, Zyra e Mbrojtjes dhe Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave kanë marrë kërkesa të shumta për pranime në lista. Shqyrtimi i kërkesave dhe procesi i pranimi të mbrojtësve vazhdon, si rrjedhojë këto lista të mbrojtësve do të përditësohen vazhdimisht dhe në to do të pranohen edhe kandidatë të tjerë, ndërkohë që vazhdon procesi i shqyrtimit të kandidaturave të tyre. Ky proces do të mbetet i hapur.



nisë punën kjo gjykatë dhe kur do të ngrihen aktakuzat?

Gashi: Emërimi i kryeprokurorit amerikan Jack Smith nuk është i rastësishëm pasi që të gjithë kryeprokurorët që veprojnë në kuadër të Gjykatës Speciale në Hagë kanë qenë amerikanë. Kjo është bërë e qëllimshme që ish-pjesëtarët e UÇK-së të cilët do të akuzohen në Gjykatën Speciale të mos kenë mundësi t'i kritikojnë prokurorët amerikanë për njëanshmëri. Askush saktë përveç kryeprokurorit Jack Smith nuk e di se kur do të ngrihen akuzat e para nga zyra e prokurorit special në Hagë. Gjykata Speciale nuk mund të jetë aktive pa aktakuza dhe kjo e gjitha është në duar të prokurorit Jack Smith.

"Epoka e re": Ka gjasa që aktakuzat e para të ngrihen në verë ashtu siç është përfolur apo kryeprokurorit të ri do t'i duhet kohë për lëndët?

Gashi: Kryeprokurori Jack Smith ka përvojë juridike në

Dhjetëra imamë do t'u ligjërojnë të dënuarve kundër terrorizmit

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, pas nënshkrimit të marrëveshjes me kryetarin e Bashkësinë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, ka shprehur bindjen se organizimi i ligjëratave fetare për të burgosurit do ta rrisë vetëdijen lidhur me rreziqet e radikalizmit fetar

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 MAJ - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si dhe kryetari i Bashkësinë Islame të Kosovës, myftiu Naim Tërnavë, kanë nënshkruar të premten marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e rehabilitimit dhe riintegritetit të personave të burgosur sipas legjislacionit në fuqi. Me këtë rast, ministri Tahiri ka shprehur bindjen se organizimi i ligjëratave fetare për të burgosurit do të rrisë vetëdijen lidhur me rreziqet e radikalizmit fetar. "Përmes ofrimit dhe organizimit të ligjëratave fetare për të burgosurit në institucionet korrektuese, besojmë shumë se do të rritet vetëdija si në mesin e personave të privuar nga liria që mbahen në institucionet korrektuese, po ashtu edhe në

institucionet e përfshira në zbatimin e këtij memorandumi", është shprehur Tahiri.

Ministri Tahiri ka theksuar se idetë e radikalizmit kanë përfshirë gjithë botën dhe Kosova nuk ka mbetur immune nga kjo dukuri. Megjithatë, sipas tij, numri i pjesëmarrësve në konfliktet e huaja ka rënë dukshëm. "Fatmirësisht ka rënë ndjeshëm numri i qytetarëve të Kosovës që janë pjesë e konflikteve të huaja, falë edhe angazhimit institucional për të ndërmarrë masa konkrete për parandalimin e këtij fenomeni. Megjithatë, edhe ata që janë kthyer edhe ata që janë aktualisht në vuajtje të dënimit, në esencë janë qytetarë të Kosovës dhe meritojnë kujdesin tonë", ka thënë Tahiri. Ndërkaq kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, ka thënë se BIK-u do

të jetë i angazhuar për dhënien e kontributit për luftimin e çfarëdo forme të radikalizmit fetar. Tërnavë është shprehur i bindur se të njëzetë imamët e përzgjedhur do të ndihmojnë në deradikalizimin e të burgos

surve pasi, sipas tij, radikalizmi dhe ekstremizmi fetar nuk kanë asnjë lidhje me islam. Sipas marrëveshjes, Bashkësia Islame e Kosovës angazhohet për sigurimin e ligjëratave fetare nga lista e imamëve të BIK-ut e

verifikuar në mënyrë të duhur, ndërsa Ministria e Drejtësisë siguron hapësirat për mbajtjen e ligjëratave si dhe bën ofrimin e sigurisë për zyrtarët fetarë gjatë vizitave të tyre në institucionet korrektuese.

Kolegji DMACC i Iowas do të veprojë edhe në Kosovë

**EPOKA
ERE****Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 11 MAJ - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe presidenti i DMACC (Des Moines Area Community College), Robert Denson, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për themelimin e Akademisë së Arsimit Profesional në Kosovë, degë e Kolegjit DMACC të Iowas. Ministri Bytyqi me këtë rast është shprehur jashtëzakonisht falënderues për gatishmërinë që shteti i Iowas, në kuadër të krijimit të një partneriteti strategjik me Kosovën, po e mbështet fushën e edukimit,



tashmë përmes një bashkëpunimi konkret. Bytyqi ka theksuar se nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për themelimin e degës së Kolegjit DMACC në

Kosovë është një hap drejt ndryshimit të gjendjes së arsimit të lartë. "Ardhja e një Kolegji prestigjioz nga shteti i Iowas është një lajm i jashtëzakonshëm

për të gjithë ne, veçanërisht për të rinjtë tanë, të cilët do të kenë mundësi që në këtë Kolegj të marrin një edukim profesional çfarë e kanë të rinjtë në Iowa. Falënderoj DMACC për gatishmërinë që ta përkrahë themelimin e këtij kolegji në Kosovë, të cilët janë të gatshëm të na ndihmojnë për të pasur një kolegji siç e kanë edhe në ShBA", ka thënë ministri Bytyqi.

Ndërsa presidenti i Kolegjit (Des Moines Area Community College), Robert Denson, ka thënë se DMACC është e specializuar për aftësimin e punëtorëve në kompani të ndryshme, duke shtuar se do të punojnë me institutet më të mira të Iowas,

për ta garantuar sjelljen e përvojave më të mira në Kosovë. Denson u shpreh i gatshëm për ta thelluar edhe më tutje bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve në fushën e edukimit përmes projekteve të tjera. Marrëveshja që është nënshkruar i ka hapur rrugë Kolegjit të njohur DMACC, i cili do të ketë profile profesionale të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës në Kosovë. Standardi i këtij kolegji është në përputhje të plotë me ato që zhvillon Kolegji DMACC në Iowa. Në kuadër të marrëveshjes parashihet që profesorë nga DMACC t'i trajnojnë profesorët tanë, të cilët do të jenë pjesë e kolegjit.

Rikalo e pezullon Elhami Hajdarin nga posti i drejtorit të AZhB-së

PRISHTINË, 11 MAJ - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, e ka pezulluar Elhami Hajdarin nga pozita e drejtorit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB). "Pas shumë ankesave dhe padive të cilat janë adresuar nga fermerët kundër punës së kësaj Agjencie, si dhe konfirmimi nga Prokuroria që është

hapur proces ndaj tij, unë kam marrë vendim për pezullim të z. Hajdari. Arsyeja e këtij vendimi lidhet me çështjen e korrupsionit. Unë nuk mund të toleroj të vazhdoj në këtë mënyrë që ta shkatërroj imazhin e Ministrisë së Bujqësisë. Zotëria në fjalë për një kohë të gjatë është nën hetime nga policia dhe prokuroria dhe nga ky pozi-

cion, si drejtor i Agjencisë, ai nuk mund të ushtroj presion në proceset e hetuesisë", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie.

Ndërkaq kryeshefi i AZhB-së, Elhami Hajdari, ka thënë se kompania nga Prizreni "Extra Fruits Fillings" kishte lidhje me kompaninë "Concept Pro" me seli në Serbi, në të cilën drejtoreshë është gruaja e

Nenad Rikalos, ministrit të Bujqësisë. "Ky vendim i ministrit Rikalo vjen pas mospërkrahjes së kompanisë 'Extra Fruit Fillings', që ka marrëveshje me gruan e Rikalos, 'Concept Pro', ku përfaqësues është gruaja e Rikalos, Biljana Rikalo, kompani e cila ka qenë përfituese për projekte të zhvillimit rural në vitin 2015, por që

kompania i ka kaluar të gjitha afatet kohore për implementimin e projektit dhe duke u bazuar në programin, Udhëzimin Administrativ dhe kontratën, kësaj kompanie i është kërkuar kthimi i mjeteve avanc të dhëna më herët dhe për moskthim brenda afateve ligjore, është proceduar në gjykatë", ka thënë Hajdari për gazetën "JnK".

Deri në fund të majit Kosova duhet t'i zbatojë obligimet e agjendës evropiane

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka kërkuar nga kabineti qeveritar që deri në fund të këtij muaji t'i zbatojë prioritetet e Agjendës për Reforma Evropiane. Kjo kërkesë e ministres Hoxha është mbështetur edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka kërkuar nga ministrat të kenë përkushtim maksimal për t'i kryer obligimet, duke trajtuar me seriozitet detyrat që kanë në resorët e tyre

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 11 MAJ - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, të premten ka kërkuar nga kabineti qeveritar zbatimin e prioritetëve të agjendës evropiane. Ajo u ka thënë kolegëve të

vet, se deri në fund të këtij muaji duhen kryer detyrat dhe obligimet që dalin nga prioritetet e Agjendës për Reforma Evropiane.

Ministrja Hoxha ka thënë se pret që dinamizimi i këtij procesi të japë rezultate në sektorët e apostrofuar. Në mbledhjen e Qeverisë

mbajtur të premten, ministrja Hoxha ka prezantuar për miratim Strategjinë e Komunikimit dhe Informimit në mbështetje të procesit të integrimit evropian të Kosovës 2018-2021. Ajo ka thënë se kjo strategji trajton komunikimin e procesit të integrimit evropian, respektivisht Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Sipas Hoxhës, Strategjia ka për qëllim edhe ndërtimin e mirëkuptimit të qendrueshëm dhe të thellë në mes të qytetarëve të Kosovës për të gjitha aspektet e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke përfshirë sfidat, përfitimet dhe detyrimet.

Në këtë mënyrë ajo ka treguar se qytetarëve do t'u mundësohet të

bëjnë zgjedhje të informuar dhe të marrin pjesë aktivisht në formësimin e së ardhmes evropiane të Kosovës. Gjithashtu, ministrja Hoxha ka kërkuar mbështetjen e kabinetit qeveritar për ta miratuar strukturën organizative të KIESA-s dhe themelimit të bordit të saj, planin e veprimit për zbatimin e strategjisë për luftimin e ekonomisë joformale, përfundimin e vlerësimit të rrezikut për sektorin e OJQ-ve, sigurimin e buxhetit në kuadër të KASH-it 2019-2021 për transferimin e inspektorëve nga niveli komunal në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës si dhe ratifikimin e traktatit të komunitetit të transportit dhe gjetjen e lokacionit të përshtatshëm për ndërtimin e objektit

për deponimin e mbeturinave të rrezikshme.

Ministrja Hoxha ka paraqitur edhe kërkesën për miratimin në parim të Marrëveshjes Financiare për IPA 2018 me Bashkimin Evropian. "Më 10 prill 2018 nga Ministria e Punëve të Jashtme kemi pranuar rekomandimin për miratimin në parim të kësaj marrëveshjeje. Hapi i ardhshëm, bazuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare, është miratimi në parim i nismës nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka theksuar ministrja Hoxha.

Të gjitha propozimet, për miratim, të ministres Hoxha, janë aprovuar në kabinetin qeveritar.?



Hoti thotë se vendimet e Qeverisë Haradinaj nuk janë legjitime

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të premten se institucionet shtetërore kanë humbur legjitimitetin demokratik dhe janë bërë jofunkionale. "Qeveria nuk e ka shumicën në Kuvendin e Kosovës. Rrjedhimisht, Qeveria nuk ka legjitimitet qytetar e demokratik. Vendimet e saj nuk janë legjitime dhe do të anulohen në Qeverinë e ardhshme. Funksionimi i Kuvendit është vënë në pikëpyetje. Seancat nuk thirren me rregull dhe dështojnë

për mungesë kuorumi. Nga 24 seanca që janë mbajtur deri më tani, 20 prej tyre janë shtyrë kryesisht për mungesë kuorumi. Mbledhjet e komisioneve dështojnë për mungesë kuorumi. Në mungesë të shumicës parlamentare, koalicioni qeverisës bllokoi çështjet në Kuvend me mospjesëmarrje në votim", ka thënë Hoti. Ai ka thënë se ministrat dhe kryeministri nuk paraqiten në seancë dhe në komisione parlamentare.

Duke folur për tryezën e partive politike, Hoti ka theksuar se qëllimi i këtyre tryezave është dalja

nga kriza politike përmes caktimit të datës së zgjedhjeve dhe pajtim-it për punët që duhet të kryhen nga institucionet deri në zgjedhjet e reja, në mënyrë që mos të ngecin reformat për integrim evropian dhe proceset e tjera të rëndësishme nacionale.

Hoti ka thënë se ambicia për pushtet e kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit po mbi-zotëron përpara interesit nacional dhe përgjegjësisë qytetare që duhet të tregojnë bartësit e institucioneve. "Tryeza e ardhshme duhet të qartësojë gjithçka në këtë drejtim", ka pohuar Hoti.



17 milionë euro për rehabilitimin e hekurudhës Fushë Kosovë - Mitrovicë

**EPOKA
ERE****Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 MAJ - Hekurudhat e Kosovës do të jenë përfituese të një granti mbi 17 milionë euro, pasi në mbledhjen e së premtes të Qeverisë së Kosovës është miratuar nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për negociim të marrëveshjes për grant nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), për financimin e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore Fushë Kosovë - Mitrovicë. Shuma e garantit ka vlerën 17

200 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë eurosh).

Në mbledhjen e kabinetit qeveritar është miratuar vendimi për t'i rekomanduar presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit ministrit të Financave për nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare për financimin e ndërtimit të rrugës Kijevë-Zahaj.

Marrëveshja financiare për këtë projekt ka vlerën 80 milionë euro. Kjo marrëveshje kompletton financimin nga institucionet ndërkombëtare financiare për autostradën Kijevë-Zahaj, e cila

financohet me 71 milionë euro kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe 17 milionë euro fonde nga burimet e tjera.

Miratimin në mbledhjen e Qeverisë e ka marrë edhe vendimi preliminar për shpronësimin e përhershëm dhe krijimin e së drejtës së servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projekteve për ndërtimin e linjave elektrike në Therandë, Rahovec, Drenas, Prishtinë, Mitrovicë, Fushë-Kosovë dhe Graçanicë.

Edhe vendimi për shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës për shpronësim të pronave të paluajtshme që preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, ka marrë miratimin e Qeverisë. Shpronësimi prek pronat në segmentin Banullë-Bresalc që gjenden në komunat e Lipjanit, Graçanicës, Novo Bërdës dhe Gjilanit.

Miratimin në parim të kabinetit qeveritar e ka marrë edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes financiare trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë, për programin

e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II në mes të Kosovës dhe Maqedonisë. Për realizimin e këtij programi, kontributi financiar i Bashkimit Evropian është në vlerë 840 mijë euro.

Gjithashtu, në parim është miratuar edhe nisma e lidhjes së marrëveshjes trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë për programin e bashkëpunimit ndërkufitar, IPA II, në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për vitet 2015-2017. Edhe në këtë rast kontributi financiar i Bashkimit Evropian ka vlerën prej 840 mijë eurosh.



OEK-u i jep mirënjohje ndërmarrjes 'Vali Ranch'

**EPOKA
ERE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 11 MAJ - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka ndarë të premten mirënjohje për ndërmarrjen "Vali Ranch", për pronarin Fehmi Fetahu, për kontributin e dhënë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, për promovimin e vlerave të ndërmarrësisë vendore, për promovimin e investimeve të diasporës si dhe për përmirësimin e imazhit të Kosovës në përgjithësi.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se nuk mund të ketë zhvillim ekonomik të vendit pa përfshirjen e diasporës. "Kjo njohje i jepet njërit prej biznesmenëve më të suksesshëm në Kosovë që jeton dhe vepron në Zvicër. Si mund të kemi zhvillim ekonomik pa kontributin e diasporës. Për



diasporën të bëjmë më tepër sesa të pyesim se çfarë bën diaspora për Kosovën. Është z. Fehmi me zonjën Rita që me mund dhe me punë të palodhshme bën inves-

time në Kosovë, duke krijuar kompaninë 'Vali Ranch', e cila ka dhënë kontribut të pakontestueshëm social. Ky njeri ka qenë i palodhshëm në pro-

movimin e vlerave të Kosovës dhe kombit", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se atë më të voglën që ka bërë Oda Ekonomike e Kosovës për Fetahun është kjo

mirënjohje. Gërxhaliu ka theksuar se kjo mirënjohje le të jetë mesazh ndaj diasporës që Oda Ekonomike e Kosovës është me diasporën.

Ndërsa Fehmi Fetahu, pronar i ndërmarrjes "Vali Ranch", ka thënë se është nder i madh që OEK-u vlerëson punën e diasporës dhe investimet që po bëhen në Kosovë. "Është kënaqësi që dikush vlerëson punën e diasporës, vlerëson mundin dhe investimet që bëhen në Kosovë. Pa investime të diasporës, pa afrim të diasporës, Kosova e ka vështirë. Dua ta falënderoj kryetarin e Odës Ekonomike, Safet Garxhaliu, që i ka ra ndër mend ta vlerësoj punën time", ka thënë Fetahu. Ai ka bërë thirrje që të investohet sa më shumë në Kosovë, pavarësisht prej sfidave që paraqiten e që, sipas tij, me mund arrihet gjithçka.

Kryeministri kërkon angazhim për ringjalljen e Trepçës



PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - "Qeveria e Kosovës vitin 2018 e ka shpallur vit të Trepçës. Kështu që, të gjithë duhet të punojmë me përkushtimin më të madh që ky gjigant të ringjallet, të aktivizohen resurset dhe Trepça të kthehet në misionin e saj, zhvillimin e Kosovës", kështu ka thënë të premten kryeministri i Ramush

Haradinaj në takimin me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të "Trepça, Sh. A.", të kryesuar nga Ardian Syla. Duke theksuar rëndësinë e madhe që ka Trepça për zhvillimin ekonomik të Kosovës, kryeministri Haradinaj kërkoi nga anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të "Trepça, Sh. A.",

që transparenca, llogaridhënia dhe përkushtimi deri në funksionimin e tërësishëm të të gjitha njësive afariste të Trepçës, të jenë prioritet gjatë punës së Bordit Mbikëqyrës. Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të "Trepça, Sh. A.", Ardian Syla, e ka njoftuar kryeministrin Haradinaj me punët që janë

bërë që nga takimi i parë, për hartimin e statutit të Trepçës, regjistrimin e saj si shoqëri aksionare si dhe për zgjedhjen e bordit menaxhues. Ndërkaq kryeministri Haradinaj ka inkurajuar anëtarët e Bordit që përkushtohen për zgjidhjen dhe tejkalimin e të gjitha problemeve, veçmas

për finalizimin e statutit të Trepçës, duke ofruar mbështetjen e pakursyer të Qeverisë. Në takim morën pjesë edhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka dhe ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj.

Nisin punimet për zgjerimin e rrugës ‘Rrethrotullimi Besi-Podujevë’

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Të premten në Gllamnik të Podujevës ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka inauguruar fillimin e punimeve të rrugës nacionale N 25, "Rrethrotullimi Besi - Podujevë, segmenti Lluzhan-Gllamnik". Ministri Lekaj ka thënë se janë duke filluar një punë me rëndësi për Podujevën, për lidhjen e Prishtinës me këtë komunë përmes rrugës nacionale N 25, me gjatësi prej 4 kilometrash, me kosto rreth 5 milionë euro. Ai ka bërë me dije se punët për zgjerimin e kësaj rruge do të kryhen për 200 ditë. "Për mua si ministër dhe bashkëpunëtorët e mi ky është një projekt i veçantë. Ne nuk do të ndalemi, do të vazhdojmë me projekte të tilla. Sot e kemi filluar këtu në Podujevë, javën e ardhshme do ta fillojmë për Mitrovicë



dhe mund të them se jam mjaft i lumtur që po implementojmë me përpikëri të gjitha ato projekte që kanë fjetur për vite të tëra", ka thënë Lekaj, duke shtuar se brenda këtij viti do t'i vazhdojnë llotet e tjera, sapo të përfundojnë procedurat. Ndërkaq nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka thënë se ky projekt është i rëndësishëm për qytetarët dhe vendin, sidomos për ata që jetojnë në Evropë, sepse kjo është arteria kryesore që e lidhë Kosovën me botën e jashtme.

Limaj e Gashi në AKP: T'i përcaktojmë asetet që janë investime strategjike

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka mbajtur të premten takim me zyrtarët e lartë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilët ka biseduar për një numër të çështjeve që lidhen drejtpërdrejt me ligjin për investime strategjike. Në këtë takim koordinues të

realizuar për përcaktimin e asetëve që do të hyjnë brenda kornizës së investimeve strategjike ishte i pranishëm edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, kryesuesi i Bordit të AKP, Petrit Gashi dhe drejtori i AKP-së, Ekrem Hajdari. "Ne jemi të interesuar të përparojmë me proceset si Brezovica, Grandi dhe asete të tjera me interes të

veçantë. Së bashku besoj se mund t'i shtyjmë përpara proceset me interes për vendin tonë", ka thënë ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi. Në fund të takimit palët u pajtuan të realizojnë edhe një takim të radhës ku do të diskutohen projektet individuale dhe do të dilet edhe me rezultate konkrete.



Komunat shënojnë progres në shpenzimin e buxhetit

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Zëvendësministri i Administrimit të Pushteti Lokal, Beqir Fejzullahu, ka bërë me dije të premtën se raporti lidhur me të arriturat dhe sfidat e komunave për vitin 2017 i është dorëzuar në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës. Fejzullahu ka thënë se komunat janë duke bërë avancim të vazhdueshëm. "Komunat kanë ndër-tuar një sistem të shëndoshë demokratik duke zbatuar detyrat që rrjedhin nga legjislacioni. Është viti i tretë i strategjisë së vetëqeverisjes lokale 2016-2026 dhe MAPL ka punuar ngushtë me komunat për realizimin e detyrave që rrjedhin nga kjo, si dhe janë duke u zhvilluar një sërë aktivitete që promovojnë qytetarinë aktive", ka thënë Fejzullahu, duke shtuar se trendi

i përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje është pozitiv. Sipas tij, komunat kanë përparuar në shpenzimin e buxhetit, ku në përgjithësi është shpenzuar 90 për qind e buxhetit. Në publikimin e Raportit të Funksionimit të Komunave është bërë me dije se janë evidentuar edhe disa raste komunale që kanë nevojë për përputhshmëri me aktet ligjore. Sa i përket agjendës evropiane, sekretarja e përgjithshme e MAPL-së, Rozafa Ukimeraj, ka treguar se janë përmbyshur 67 për qind e kriterëve. Gjithashtu, është bërë me dije se në disa komuna ka pasur probleme me dhënien e tokave, nuk janë themeluar disa komitete konsultative dhe se raportimet e kryetarëve dhe tubimet me qytetarë nuk janë përmbyshur sa duhet.



Ferizaj bëhet me Qendër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

FERIZAJ, 11 MAJ - (ER) Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj dhe kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për financimin e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në këtë qytet. Nënshkrimi i këtij memorandum është bërë të premtën në

një ceremoni të organizuar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara. Me këtë rast, ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka deklaruar se Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të jetë mundësi e mirë për ferizajasit, në veçanti për të rinjtë, që t'i zhvillojnë idetë e tyre inovative dhe t'i përdorin ato

në dobi ekonomike për vendin. Kurse kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar ministrin Beqaj për përkrahjen për themelimin e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Ai ka se themelemi i kësaj qendre është projekt i madh dhe i rëndësishëm për Ferizajn dhe qytetarët e kësaj komune.

Parkingu nëntokësor në kryeqytet do të kushtojë 12 milionë euro

PRISHTINË, 11 MAJ (ER) - Të premtën në Prishtinë është prezantuar projekti që ndihmon për zgjidhjen e një prej problemeve kryesore brenda trafikut në kryeqytet - problemën e parkingjeve. Bëhet fjalë për parkingun nëntokësor te Fakulteti i Filologjisë, parking ky që pritët të ketë kapacitet për, së paku, 500 automjete. Sipas një njoftimi të Komunës së Prishtinës, lokacioni në qendër të qytetit, me ç'rast edhe sheshi edhe rrugët e tjera kryesore janë afër, është një nga përparësitë e mëdha që nxisin shndërrimin e kësaj hapësire në parking të përshatshëm nëntokësor. "Investitori që do ta bëjë ndërtimin ka për obligim që hapësirën mbi parking ta shndërrojë në park publik me qasje për të gjithë, ajo hapësirë

më pas lidhet me shëtitoren që planifikohet të zgjatet nga sheshi deri tek udhëkryqi pranë Katedrales", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Sipërfaqja e ndarë për këtë projekt është 13 990 metra katrorë dhe me planin rregullues mund të shkohet në dy nivele nëntokë. Rreth 500 metra katrorë në këtë hapësirë janë të ndara për pjesën komerciale, ashtu që të shfrytëzohet disniveli aktual që është brenda parcelës. "Së shpejti Komuna e Prishtinës do ta fillojë procedurën e kualifikimit, e cila i paraprinë procedurës së ofertimit për projektin në fjalë. Vlera e parashikuar për ndërtimin e këtij parkingu përmes partneritetit publiko-privat është 12 milionë euro", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Vazhdon asfaltimi i rrugëve në fshatin Stantërg të Mitrovicës

Mitrovicë, 11 maj (ER) - Ka filluar asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në fshatin Stantërg të Mitrovicës. Sipas një njoftimi të Komunës së Mitrovicës, janë

disa rrugë dhe rrugica të cilat priten të asfaltohen në këtë fshat, me ç'rast do të përfundojë pothuajse rregullimi i tërë infrastrukturës rrugore. Me këtë rast,


drejtori i Infrastrukturës, Naser Muja, ka thënë se me asfaltimin e kësaj rruge dhe rrugicave të tjera, banorët e fshatit Stantërg në përgjithësi do të kenë jetë më

të mirë dhe mundësi më të mëdha për ta siguruar ekzistencën. Vlera e këtij projekti arrin shumën afër 90 mijë euro.



Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri, vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk guxon të nëpërkëmbet (2)

Filozofia e shkollës për orientim kombëtar për vetëvendosje dhe pavarësi



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Përkrahësit e këtij drejtimi filozofik janë diku në gjysmë të rrugës për ta shpjeguar bazamentin e neoluftës. Kjo shkollë, në shikimin e parë tërë çështjen, vërehet strukturalist se nuk e ka vendosur drejt ende. Përplasjet që janë dhe do t'i kemi, duhet të konceptualizohen se lufta e drejtë, qoftë ajo mbrojtëse qoftë ajo ofensive, e që ka karakter çlirimtar, duhet të vihet në fronin që e meriton në shkencë. Fundi kësaj shkolle doktrinare gjeostrategjike dhe gjeopolitike ende nuk është shpërblyer me vlerën objektive, sepse në esencë kjo shkollë respekton doktrinën shpirtërore dhe taktikën e shoqërisë së vendosur për luftë të drejtë dhe për sakrificë, për të dalë nga terri i shoqërisë konfliktuoze-gjenocidale, që planifikon okupatori në çdo kohë dhe rrethanë. Kjo shkollë disi me epërsi stilizuese është kah e nënçmon strategjinë ushtarake të UÇK-së dhe prej saj, jo, por për së jashtmi është e akuzuar dhe e ndrydhur tmerrsisht, gjithnjë duke iu frikuar modelit që mos të metastazojë. (Shikoni vendet e BE-së që nuk e kanë pranuar Kosovën, pse hezitojnë, sepse i kanë nga 2-4 Kosova brenda!). Sepse për ndryshe nga kundërshtarët duhet të pranohet objektivi i drejtësisë universale

për popujt e kolonizuar, të cilët me Rezolutën e OKB-së më 1960-n, duhet të çlirohen. E tërë lufta që zhvillohet hapur kundër UÇK-së me metateza të çuditshme, na ka vënë sot në një pozicion që duhet disi prapë të mbrohemi. Dhe këtu paleoluftëtarët e shohin shansin e tyre të na kthejnë prapa. Kjo fotamorganë politike disi edhe nga disa "analistë" analfabet e të shqiptarët të tillë ka për eksport, po shpjegohet dhe po sulmohet lufta e drejt si fantazi, sepse sipas tyre pa "faktorin e jashtëm nuk do të kishim asgjë". Ky nihilizëm që nuk e njeh faktorin e brendshëm si primar, dhe faktorin e jashtëm se si lehtësim, kurrë nuk do ta kuptojë të vërtetën. E pra, jo vetëm sot, por edhe dje, pjesa më e madhe e shoqërisë "kosovare" po shihet sikur nuk dinë çka do të dëshiron nesër, sepse në saje të moralizimit të sjelljeve komode dhe servile, ka mundësi të kalkulohet, të metrifikohet dhe gjithnjë është në luftë për të blerë kohë duke shpresuar që të barazohet ai që ka derdhë gjak me të që ka sabotuar luftën, madje publikisht dhe me kërcënime. Kjo shkollë nuk është e vetëdijshme se duke "blerë kohë", për pjesëmarrje në luftë me fraza, "në liri për lirinë", nëpër kafene po provon në shkallë injorante për të na kthyer në kornizat e "Helsinki" 1975, të cilat korniza sot janë bërë copë e grimë. Kështu logjika e luftës së drejtë ia vlen të popullarizohet, për ta ndërtuar në shkollë aksiologjike kauzale të civilizimit. Po, do të ketë neolufta kundërshtarë të "nderuar", sepse ma në fund duhet të "merremi vesh" pa qare, por ata që do të mbesin në pakicë

dhe në shpirtin e tyre të vogëlsisë, do të mbijetojnë si forcë minore, për aq sa me një mit të prirur që nga lufta e drejtë ta nxjerrim doktrinën reale të popullit sovran që vetëvendose. Kuptojeni. A kemi vetëm në fuqi intelektuale ta bëjmë këtë, dihet se mundësitë janë fare të kufizuara që ta përthekojë botën shumë shpejtë kjo shkollë. Por, këtë luftë duhet ta shoqërojmë me studime të mirëfillta dhe ato t'i distribuojmë në të gjitha meridianët e botës, sepse vetëm ashtu fitorja do të shndërrohet në garanci. Të besosh në këtë realitet, duhet studiuar luftën e UÇK-së, jo vetëm nga këndi historik i lirisë, por edhe nga këndet psikologjike, pedagogjike, logjike, filozofike, dhe drejtësisë universale. Kështu krijohet shanse që shkolla e të drejtave të njeriut, do ta ndryshojë strategjinë, dhe një ditë do të i thotë. Po pavarësisë së vërtetë për Kosovën. E shumicës së popullit pastaj i mbetet që të dëshmohet se lufta pa hile në rrafshin e të drejtave të njeriut të bazohet në luftë edhe më të vendosur, për të drejta të garantuara të pakicave. Ky realitet është i pashmangshëm në historinë që po vjen, sepse teknologjia këtë fat e siguron. S'ka ma popuj dhe luftëra që do të mbesin anonime. Bota është në Epokën e informatave dhe për këtë fuqi për çdo ditë po bëhet e vogël dhe më e vogël. Po sa informata në të kaluarën kanë mbetur të vdekura, sepse për to nuk kemi informata. Informata pra është bërë fuqi prodhimi më tepër se kurrë më parë. Edhe një observim shikuar nga këndi shkencor racionalist, Shkolla e Luftës për të drejtat e njeriut, luftën e UÇK-së edhe sot

as nuk e shpie në rrugë, as nuk e largon prej saj, sepse nuk ka marrë pjesë në krijimin e asaj filozofie, por as nuk e largon prej "rrugës" rreshtimit për pavarësi të Kosovës, në rastin konkret, sepse aty në fundin e rrugës disi e dedikuar nga faktori i jashtëm është bërë tërthorazi promotor i saj, vetëm për t'u dukur se kemi të bëjmë me sjellje humane. E vërteta, pa ekuivokë duhet ta dimë se tërë godinën shoqërore, varësisht ku zhvillohet ngjarja, kjo shkollë sot e çon në ajër, sepse frikohet prej ajrit të lirë. Madje, kohë pas kohe, edhe pse neve disi na duket e përafërt dhe "vëllazërore", madje deri në ekstrem miqësore, kjo shkollë doktrinarë gjeostrategjike tërë shoqërinë shqiptare e zhveshë nga ajri, nga ligjësia, madje me insinuata, me montime aferash, me burgime disa mujore dhe vjetore nëse trillon filozofi se "askush nuk është fajtor deri sa të vërtetohet". E vet i ka fabrikuar "provat" e akuzave, vet pastaj i asgjëson, vetëm për të krijuar balance në mes viktimës dhe xhelatit, nëpër rastin konkret në Kosovë dhe për Kosovën. Kërcënimi kolektiv, me Gjykata speciale, madje vetëm për UÇK-në është me tepër se racizëm. Dhe, nuk është larg kjo politikë nga dukuria, kur kjo shkollë e posedon fuqinë koloniale, por jo drejtësinë kurrë. Kjo shkollë në trurin gjysmë të retarduar të disa politikanëve shqiptarë, të cilët vota e turmës i ka bërë të "dijshëm dhe të aftë", politiken e kanë shndërruar në cirk, e jo në aftësi profesionale dhe institucionale për lumturinë ekonomike të shtetit, popullit. Ky soj i politikanëve po lëvizë çdo kujë helmuese, për t'u bërë lider pa mbulesë. Si të tillë, anëtarët e klanit që i rrethon dhe janë të kurorëzuar në padrejtësi me vetëdije, sepse prijësi ashtu i dirigjon të flasin për korrupsion e vet janë të korruptuar, të flasin për hajni dhe plagjiatura e vet janë të tillë dhe pastaj edhe kur e marrin vesh se çfarë fajesh kanë bërë nuk guxojnë të flasin, vetëm blofojnë dhe bëjnë poza pompoze metrimonike, disi në shpirtin e popullit të plagosur, duket se janë të detyruar të gjallërojnë e dirigjojnë me moton: "hetuesit e rendit janë sy qelë". E kush janë këta "hetues" vetëm një rreth i ngushtë duhet ta

dijë, sepse të gjithë hafijet e kësaj filozofie prostitucionale politike duhet të mbesin "dëshmitarë të mbrojtur". E ata dhe këta, duhet gjithnjë të mësojnë për të thënë diçka, për të kurdisë diçka. Pa këtë shkollë nuk mund të jetojnë dhe ky realitet është kancerogjene vetëvrasës. Madje ata dhe këta, i marrin dhe i sigurojnë në rrethe të mbyllura, për ta mësuar akuzën (dëshmi) të rrejshme përmendësh. Dhe deri me tash kjo zejtari e tyre ka dështuar totalisht. Çka do të sjellë e nesërmja, dihet, do ta vazhdojnë zejtarinë e vjetër, po nuk iu thyen hundët qoftë individualisht, qoftë kolektivisht. Kështu do të duhej të ishte e pashmangshëm pesha e luftës për drejtësi jo vetëm në Kosovë, ku eksperimentohet me të madhe, sepse vuajtjet e popullit pastaj nuk ka kush t'i objektivizojë në asnjë instancë. Sot nuk ka vlerë më të shenjë se sa opinioni ynë ta dinë fare mirë dhe pa dilema se vlerat e Luftës së UÇK-së, nëse injorohen dhe politizohen, por edhe kriminalizohen, liria dhe pavarësia do të shndërrohen në tregti pranë tavolinave diplomatike, ku fusnotat janë të gatshme, madje jo në kokë, por ato i kanë në gjepa, sepse shpresojnë se do t'u shpaguehen. Këtë mentalitet trunor ta quajmë, të konceptuar mbrapshtë, të ngritur në deklarata boshë, dhe "koshiqe" pa bletë, duan ta krijojnë sidomos shtresa politike e pa arsimuar dhe konservatore pacifiste në gjenetikë, që përgjohet në çdo vend ku gjendesh fizikisht, nëse cilësoshesh se je i taborit të neoluftës. Nuk është këtu çështja e taborëve. Prandaj, realitetin e Luftës së drejtë në Kosovë, të gjithë ata që nuk e konceptojnë drejtë, sepse bien ndesh me politikën e tyre neokoloniale, duan se duan ta konceptojnë si "luftë humanitare". Termë "humanitare" që okupatorin nuk e brengosë, sepse shihet se luftë humanitare nuk ka sepse vrite njerëzit, jeta e tyre nuk shpëtohet. Kështu okupatori ka mbetur në rastin e Kosovës që të përsëritet historia, e ku në fund nuk ka vetëvendosje. Prandaj, çdo gjë për luftë të drejtë, çdo gjë për vetëvendosje, është rreshtimi që ia vënë frikën në palcë çdo grabitqari tani e tutje. Këtu qëndron fama e UÇK-së. (Vijon)



Nis rregullimi i varrezave të dëshmorëve në Malishevë

MALISHEVË, 11 MAJ (ER) - Ka nisur rregullimi i hapësirës, përkatësisht ndërtimi i lapidarit në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, aty ku prehen të gjithë dëshmorët e Brigadës 122 "Imer Krasniqi". Ndërtimin dhe rregullimin e sheshit në këto

varreza është duke e bërë Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Këto punime kanë filluar tani në prag të shënimit të 16 qershorit, Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës dhe Ditës së Çlirimit të Komunës së Malishevës që

lidhet me rënien e dëshmorit të parë, Imer Krasniqi, i rënë më 16 qershor të vitit 1998 dhe të dëshmorit të fundit, Mentor Gashi, i rënë më 16 qershor të vitit 1999. Më 16 qershor 1999 është çliruar Komuna e Malishevës.



Merkel: Tërheqja e ShBA-së nga pakti dëmton rregullin botëror

BERLIN, 11 MAJ - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë më 11 maj se vendimi i Shteteve të Bashkuara për t'u larguar nga marrëveshja bërthamore me Iranin dëmton besimin në rregullin botëror. Merkeli ka thënë se marrëveshja e cila përcakton se Irani duhet t'i frenojë aktivitetet bërthamore në këmbim të lirimit nga sanksionet është largësi përkyerës, mirëpo ka theksuar se nuk duhet të "shkëputet njëanshëm" pasi është miratuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara.

Presidenti amerikan Donald Trump, kritikizës i marrëveshjes së vitit 2015, ka njoftuar më 8 maj se ShBA-ja largohet nga marrëveshja të cilën lideri amerikan e ka cilësuar "me të meta të tmerrshme". Marrëveshja ishte arritur pas gati 20 muajsh negocia-ta në mes të Iranit në njërën anë dhe Shteteve të Bashkuara, Britanisë, Kinës, Rusisë, Francës dhe Bashkimit Evropian në anën tjetër.

Berlini dhe Moska kanë njoftuar se Merkeli ka biseduar përmes tele-

fonit me presidentin rus Vladimir Putin në përpjekje të ruajtjes së paktit.

Biseda e tyre ka ardhur një ditë pasi ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas dhe homologu i tij rus, Sergei Lavrov, janë pajtuar se marrëveshja duhet të vazhdojë së zbatuari. Në të njëjtën kohë, shefja e politikës në Bashkimin Evropian, Federica Mogherini, pritet që më 15 maj të takohet me ministrat e Jashtëm të Gjermanisë, Francës dhe Britanisë, për ta diskutuar marrëveshjen në fjalë.



Trumpi: Mendoj se takimi me Kim Jongun do të jetë i suksesshëm

I pyetur nga gazetarët rreth takimit historik, se a mendoni se takimi do të jetë i suksesshëm, Trumpi është përgjigjur "Po, mendoj se do të jetë një sukses i madh"

UASHINGTON, 11 MAJ - Pas disa javësh spekulimesh, presidenti amerikan Donald Trump njoftoi se do të takohet me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, më 12 qershor në Singapor. Ndërsa zyrtarët e administratës shprehën optimizëm përpara takimit historik, ekspertë të tjerë bënë thirrje për kujdes, duke thënë se ky është vetëm hapi i parë në një proces të gjatë dhe kompleks që synon çnuklearizimin e Gadishullit Korean. Vetëm disa orë pasi tre amerikanë të mbajtur në Korenë e Veriut shkelën në tokën amerikane, presidenti Donald Trump dha lajme të tjera, duke konfirmuar datën dhe vendndodhjen e takimit të muajit të ardhshëm midis Shteteve të Bashkuara dhe Koresë së Veriut përmes një postimi në "Twitter".

I pyetur nga gazetarët rreth takimit historik, presidenti ishte optimist.

President, a mendoni se takimi do të jetë i suksesshëm?

"Po, mendoj se do të jetë një sukses i madh", tha presidenti Trump.

Por disa nga kritikët e presidentit ishin më skeptikë.

Në Senat, udhëheqësit demokratë kritikuan lavdërimet e

presidentit për udhëheqësin e Koresë së Veriut. "Është shumë shqetësuese ta dëgjosh Donald Trumpin të thotë se Kim Jong Un i ka trajtuar amerikanët shkëlqyeshëm. Kim Jong Un është një diktator, që ka arrestuar arbitrarisht qytetarë amerikanë, ua ka grabitur atyre lirinë dhe nuk i ka lejuar të shkojnë në shtëpi te

familjet e tyre. Lirimi i tyre nuk duhet të vlerësohet, por duhet të pritej!", tha senatori Chuck Schumer.

Pas bisedimeve të muajit të kaluar mes udhëheqësve të Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut, disa thanë se zgjedhja e Singaporit për takimin e muajit të ardhshëm është logjike.

"Singapori njihet për këto lloj takimesh. Është vendi më i zhvilluar në Azinë Juglindore dhe ka siguri të lartë", thotë Patrick Cronin, me qendërën New American Security.

Ekspertët thonë se koha e bisedimeve midis Trumpit dhe Kimit reflekton një atmosferë më pozitive për dialog. "Mendoj se do të jetë e rëndësishme ajo që të dy këta drejtues arrijnë në këtë takim, çfarë lloj procesi diplomatik i strukturuar do të nisë pas këtij takimi", thotë Daryl Kimball nga Shoqata për Kontrollin e Armëve.

Analistë të tjerë thonë se është e rëndësishme të mbahet fokusi te qëllimi afatgjatë i denuklearizimit. "Mendoj se menaxhimi i pritshmërive do të jetë shumë i

rëndësishëm për këtë takim. Kemi pasur takime si ky mes Koresë së Veriut dhe asaj të Jugut në të shkuarën. Ato nuk kanë rezultuar produktive në aspektin afatgjatë. Pra, duhet t'i menaxhojmë pritshmëritë, të jemi realist rreth asaj që mund të arrihet dhe të fillojmë një proces që shpresojmë se do të japë rezultate", thotë ambasadori David Shear.

Javët e ardhshme do të jenë të ngarkuara pasi zyrtarët në Uashington dhe Phenian do ta koordinojnë logjistikën përpara takimit të muajit të ardhshëm.



Policia italiane shkatërron dy grupe terroristësh

ROMË, 11 MAJ - Policia italiane njoftoi se ka shkatërruar dy grupe të dyshuara xhihadiste përmes një operacioni të madh kundërterrorizëm që çoi në një numër arrestimesh. Bastisjet e policisë u zhvilluan në rreth 20 prona në Italinë Veriore dhe Sardenja. Ministri i Brendshëm Marco Minniti përshëndeti operacionet, duke deklaruar se dy struktura armiqësore janë neutralizuar.

Gjykatësit në veri të Italisë dhe Sardenjës lëshuan fletarrestimet

për operacionet "Luftëtarët e huaj" dhe "Syriana". Zyrtarët thanë se të dy grupet ishin të bazuara në Lombardi dhe Sardenja. Ata besojnë se kishin lidhje me militantët islamikë në Siri, përkatësisht Frontin Nusra të lidhur me al-Kaidën.

Hetuesit thanë se besonin se dy grupet vepronin në mënyrë autonome, ndonëse një individ duket se kishte lidhje me të dyja grupet.

Në një konferencë me gazetarë në Romë, kryeprokurori italian

për çështjet e terrorizmit, Federico Cafiero de Raho, tha se 14 veta u arrestuan në këto operacione, duke përfshirë 11 sirianë dhe tre marokenë. Ai tha se kundër katër prej tyre janë ngritur akuza për lidhje me organizatat terroriste. Të tjerët akuzohen për komplot për ta financuar terrorizmin, përveç krimit për ndërmjetësim financiar abuziv me qëllim të pastrimit të parave.

Të arrestuarit janë imigrantë me të drejtë banimi në Itali.



Këndvështrim për shfaqjen "Ditari i Ana Frankut", inskenuar në Teatrin e Gjakovës, nën regjinë e Drita Begollit

Drama e Anës dhe drama jonë

Emin Z. EMINI

Mbase dokumenti më unik dhe më tronditës i pasqyrimit të luftës së njeriut për mbijetesë nga çmenduria e ideologjisë naziste është, pa dyshim, ditari i së miturës, tinxherës hebreje, Ana Frank. Mbi këtë fakturë dokumentare dhe duke kundruar nga retrospektiva socio-historike është ndërtuar drama me titullin "Ditari i Ana Frankut" nga autorët Frances Goodrich dhe Albert Hackett, përkthyer nga Ali Llunji, inskenuar në Teatrin e Gjakovës, si shfaqje me dedikim për Yllka Domin, regjinë e së cilës e ka bërë Drita Begolli.

Ndonëse Ana Frank dhe familja e saj nuk kishin përjetuar tmerret e luftës së nazizmit, për më shumë se dy vjet, për aq sa kishin qendruar të ngujuar në nënkulmin e një shtëpie, nënkulmi për ta tashmë ishte shndërruar në kamp, në burg. Pavarësisht se sintagma nënkulm-kamp (burg) krahasuar me kampet e përqendrimit del të jetë pothuajse e pakuptimtë, ky nënkulm shndërrohet në sinonimin e robërisë, që vjen e bëhet një tmerr, një makth i llojit të vet për Ana Frankun, familjen e saj, familjen Van Dan dhe dentistin e vetmuar Dusel, të cilët së bashku gjejnë strehim te holandezi Kraler. Të gjithë këta janë personazhet e dramës "Ditari i Anës Frankut". Është edhe zonja Miepe, e cila ua afron kujdesin e saj të ngujuarve.

Ditari...

"Ditari..." është drama e një vajze me prejardhje hebreje, e një fëmije 13 vjeçe, aq sa kishte kur e përjetoj ikjen nga atdheu i vet, Gjermania. Ajo bashkë me familjen strehohet në Holandë. Aty, në nënkulm, zë jetë ditari i saj, si një jetë paralele që kërkon lirinë e munguar. Edhe pse ditari i saj lexohet në raste të rralla dhe të veçanta në off, drama e autores së ditarit dhe e të gjithë personazheve me të cilët është e detyruar të bashkëjetojë, nis e zhvillo-

het prej momentit të gjetjes së strehës për ta shpëtuar jetën nga uniformat e gjelbra me kryq të thyer. Dhe pas strehimit, në këtë strehë, nis tmerrri. Tmerrri i jetës pa dritën e diellit - për dritën e diellit, pa ajër të pastër - për ajër jete, pa ujë, pa bukë të mjaftueshme për të gjithë, sepse tetë persona kishin vetëm tri triska. Nis ngujimi. Nis një jetë larg jetës, mbyllur në një gëzhjojë mbijetese.

Dhe, gjatë gjithë kohës sa këta personazhe qëndrojnë të ngujuar, detyrohen të flasin me gjysmë zëri, herë-herë me pëshpërimë, të kursehen nga përdorimi i tualetit gjatë ditës, sepse nuk bën të hapen çezmat e ujit, madje detyrohen të heqin dorë nga hapësira e tyre personale dhe të ndajnë çdo centimetër me njëri-tjetrin, detyrohen të dashurojnë dhe urrejnë njëri-tjetrin, t'ia vjedhin, kotheren e bukës njëri-tjetrit. Thjesht, detyrohen ta bëjnë jetën e minjve përgjatë një kohe të pafundme duke pasur ngenë e gjithë botës për t'ia brejtur mendimet, emocionet, vuajtjet e lumturinë njëri-tjetrit. Këto dy e më shumë vite ishin të mbushura me frikë, me trishtim, me pritje se në çdo moment mund të vinin "ata" që i përndiqnin për t'i zhdukur nga faqja e dheut. Frika dhe pritja ishte makthi i tyre. E në këtë makth jetësor kishte shumë pak hapësirë për gëzime, për kremte, për shpresë. Madje, të shpresosh ishte guxim.

Ana

Shpresën për jetë e ndryjnë në vete të gjithë personazhet e nënkulmit. Në nënkulm ishte edhe Ana. E vogla. Ana, e cila shkruante me bojë shpirti ditarin e dramës së saj. Ishte zëri i saj që e mbushte këtë robëri me pak jetë e shpresë, me ato sherret e saj fëmijërore, me rritjen e shtatit të saj, me pjekurinë e parakohshme për moshën që kishte. Këtë personazh emblemantik, në skenën e Teatrit të Gjakovës, e sjell me një lojë të bukur e spontane, aktorja Yllka

Lota, e cila realizon kreacion skenik. Aty ishte edhe Piteri, djali i zotit dhe zonjës Van Dan, interpretuar nga Besfort Berberi. Këta dy të rinj, Ana dhe Piter, në fillim nuk e durojnë njëri-tjetrin, por dita-ditës jo vetëm për faktin se me kalimin e kohës arrijnë moshën e dashurisë së parë, por edhe për faktin se ata, në mungesë përzgjedhjeje, sikur detyrohen fillimisht të rrëshqasin drejt miqësisë, më pastaj edhe dashurisë për njëri-tjetrin. Mbase kjo ndodh sepse kështu është vetë qenia njerëzore. Dhe kjo dashuri, e fshehur brenda nënkulmit, është forca që i shpërthen vargonjtë e robërisë. Skenat e përjetimit të emocionit më njerëzor të këtyre dy të rinjve, që tashmë duke njohur një botë krejtësisht të re, të bukur, tronditëse për shpirtat e tyre njomakë dhe, natyrisht, po aq magjepsëse, ngjyrën gri, gati-gati të errët të shfaqjes, e cila vjen si produkt i atmosferës së temës emocionale të personazheve dhe rrethanave, përkatësisht situatave dramatike, e spërkasin me tone të çelura e të ngrohta, i japin ngjyra drite e jete atij ambienti frymëzënës dhe, kështu, nënkulmi si hapësirë skenike në të cilin nuk ndodh asgjë e gjithçka, që ka emëruesin e përbashkët të luftës për mbijetesë, kthehet e bëhet një kopsht me dy lule të vetme që shpërthejnë e lëshojnë shtat, para nesh, ndërmjet tokësore dhe hyjnore.

Pa dyshim këto skena të shfaqjes "Ditari i Ana Frankut", nën regji të Drita Begollit, do të mbesin gjatë në kujtesën e shikuesit, sidomos çasti i dëlirë të Anës, e cila, pasi përjeton për herë të parë aromën dhe shijen e emocionit njerëzor, si e pavetëdijshme kolektive psiko-biologjike për ta vazhduar jetën, llojin e racës, por edhe si nevojë, përkatësisht si motiv për të realizuar vetveten si individum njerëzor, na vjen me krejt origjinalitetin skenik dhe të papriturën e çastit që vetëm një herë mund ta ndiejmë në jetë. Dhoma-kthinë, e improvizuar, pak e ngritur e Piterit, deri tek e cila të dërgojnë ca shkallë të drunjtë, hapësirës skenike, jo vetëm në akseptin skenografik, por edhe regjisorial në kuptimin e ndërtimit të linjave kompozicionale dhe të marrëdhënieve ndërmjet personazheve, i jep dimensionin e dy niveleve në të cilat zhvillohet jeta njerëzore: I pari, ai përdhesi (ta quajmë kushtimisht përdhesi i nënkulmit), i rëndomtë pra, në të cilin banojnë të gjithë të strehuarit dhe, i dyti, i cili, për aq sa është jetësor, bëhet edhe aq astral, për dy të rinjtë. Nga niveli i dytë, si nga një botë krejtësisht tjetër, të thuash si nga një hapësirë



eterike, Ana, kjo qenie njerëzore, shkëputet nga orbita dhe rrëshqet teposhtë shkallëve si një grimcë kozmike, e cila, tashti, e tëra është e përbërë nga lënda me emrin dashuri dhe nga drita e saj. Krejt diçka tjetër ndodh në podiumin skenik. Aty priten lajmet për të reja që ndodhin jashtë mureve të ngujimit, pritet shpresa, pritet të përfundojë e keqja që kishte kapluar njerëzimin, por pritej edhe vetë fundi i personazheve. Pritej frika e përcëdoçastshme nga duart e vdekjes. Por nuk pritej, vetëm. Edhe luftohej për një marrje frymë më shumë, për një sekondë jetë më gjatë, për një kothere bukë me shumë për të mbijetuar fizikisht. Mbijetesa bëhet aq e ashpër, e egër, duke kapërcyer edhe kufijtë e humanes së qenies njerëzore, e cila shpërfaqet në skenë nëpërmjet karakterit të zotit Van Dan, në interpretim të saktë e të natyrshëm nga Ylber Mehmeti, i cili, i shtrënguar nga mungesa e ushqimit, detyrohet të ngihet natën që ta vjedhë bukën e të tjerëve, edhe të djalit të tij. Ai shndërrohet në një brejtës nënkulmi, i cili gërryen dhe han jo vetëm bukën e përditshme të bashkëvuajtësve, por edhe qelizat e tyre, shpirtin e tyre, të ardhmen e tyre, duke ua vjedhur dhe mohuar me vetëdije të drejtën për ekzistencë biologjike. Këtu, vjen e bëhet kontrapunt, personazhi i zonjës Frank (Edit Frank) - Myrvete Kurtishi, e cila spikatë me mjeshtërinë e saj prej aktoreje në skenë e debatit konfliktuoz me z. Van Dan, që në të vërtetë është skena e konfliktit me rrethanat, me situatat çnjerëzore, dramatike e ekzistencialiste nëpër të cilat detyrueshëm kalojnë të gjithë personazhet, bashkë dhe secili veç e veç.

Ekzistenca, ekuilibri dhe ne

Ekuilibri i gjithë kësaj katrahure gjithmonë gjendet te zoti Otto Frank, te personazhi i interpretuar nga Jahja Shehu, i cili, po ashtu, me përvojën e gjatë skenike, di si ta ruajë ekuilibrin e

konfliktit të brendshëm të personazhit, madje e mbizotëron me shumë masë zjarrin që e djeg dhe njëkohshëm akullin që e ndjen nga brenda tij, si pasojë e pamundësisë për të gjetur zgjidhje për ta shpëtuar familjen, vetën dhe gjithë të tjerët. Ai është trari mbajtës i kulmit - nënkulmit të të gjithëve, është burri i qëndresës, shpresës dhe mbijetesës.

Sikur të mos mjaftonin këto dy familje brenda një nënkulmi, aty strehohet edhe stomatologu Dusel, i cili bëhet zorrë nëpër këmbë për të gjithë, më së shumti për vetën. Interpretimi i Edmond Hafizademit u shton nuanca dramaciteti situatave skenike, që nga ardhja e tij duke vazhduar përgjatë gjithë zhvillimit të fabulës së dramës. Është personazh që ndodhet në veprim brenda linjës karakterologjike. Ndërsa Elida Shasivari ngjet në skenë zonjën Meipe, e cila është "messenger", lidhja në mes të botës së ndarë me mure, botës me dy hapësira robërie: botës jashtë murit dhe botës brenda tij.

Drama "Ditari i Ana Frankut" është një vepër tejet e zorshme për inskenim dhe, si e tillë, për çdo regjisor bëhet lehtësisht ndërmarrje sa provokuese po aq dhe e guximshme. Pavarësisht se shfaqja zgjat dy orë të plota, Drita Begolli, duke aplikuar qëllimshëm sisteme të ndryshme teatrore, realizon një shfaqje me linja të qarta kompozicionale, mizaskenë me koordinata të cilat jo që nuk lejon t'i përsëriten, por i ndërton sipas gradacionit të dramacitetit dhe konfliktit skenik, madje me invencion ia del të ndërtojë skena paralele, të cilat i gërsheton natyrshëm brenda tërësisë së zhvillimit të shfaqjes teatrore.

Regjisorja Drita Begolli dhe Teatri i Gjakovës, me shfaqjen "Ditari i Ana Frank", na e sjellin dramën e Anës dhe dramën tonë, dramën e njeriut dhe njerëzores së tij. Shfaqja vjen si provokim i ndërgjegjes sonë, si nevojë për një katarsis kolektiv.



E jashtëzakonshme

Gruaja e fiksuar pas ngushtimit të belit

Ish-veterania e marinës së ShBA-së mban të veshur një korse beli për 23 orë në ditë, për ta mirëmbajtur belin e ngushtë. Nëna e tre fëmijëve nga San Diego, Diana Ringo, korsënë e saj e largon vetëm për një orë gjatë ditës, atëherë kur pastrohet ose kur bën ushtrime fizike.



FOTO E DITES



Një punëtor shihet duke e pastruar kupolën qendrore në ndërtesën e Mbretëreshës Victoria në Sydney të Australisë. /AP/

E rrallë

Kapet peshku me dhëmbë si të njeriut

Ekspertët e jetës së egër kanë publikuar fotografinë e një peshku të kapur në Karolinën e Jugut. Ky lloj peshku, i quajtur peshk dele, është i veçantë pasi mund të rritet deri në 35 cm dhe peshon 21 kilogramë. Ka gojë të fortë dhe dhëmbë të mprehtë që e bëjnë të ngjashëm me të njeriut.



BARSOLETA E DITËS



Djali pyet të atin: Babi, si kuptohet kush është i dehur?

Babai: I shikon ata dy burrat aty? Po të ishe i dehur do të dilnin katër.

Djali: Babi, po aty është vetëm një burrë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER”
3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.

Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Keni shumë çështje për të zgjidhur gjatë ditës së sotme.

Pjesa e parë e ditës do të ketë aktivitete të shumta, kurse në mbrëmje do të jeni më të qetë.

**DEMI**

Idetë që keni duhet t'i vini në veprim dhe t'i zhvilloni. Problemi i vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.

vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.

**BINJAKËT**

Dikush po mundohet t'ju vë shkopinj nën rrota sot. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm do të dini si të dilni nga kjo situatë.

nën rrota sot. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm do të dini si të dilni nga kjo situatë.

**GAFORRJA**

Mund t'i lini gjërat të rrjedhin vetë. E rëndësishme është që në një moment të caktuar ju do ta keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.

rëndësishme është që në një moment të caktuar ju do ta keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.

**LUANI**

Hap pas hapi do të arrini t'i mblidhni edhe ju sukseset tuaja. Shijoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.

edhe ju sukseset tuaja. Shijoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.

**VIRGJËRËSHA**

Në varësi të humorit do ta keni edhe sjelljen sot. Personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.

edhe sjelljen sot. Personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.

**PESHORJA**

Jeni vëzhgues të mençur dhe sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.

sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.

**AKREPI**

Sot nuk duhet të ekzagjeroni në kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkonit mund të kenë kushtet për t'u realizuar.

kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkonit mund të kenë kushtet për t'u realizuar.

**SHIGJETARI**

Mos kërkonit aventura sot sepse nuk do të mund ta përballoni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.

nuk do të mund ta përballoni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.

**BRICJAPI**

Indiferenca në shumë raste është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon momente të dhimbshme që mund të na lëndojnë.

është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon momente të dhimbshme që mund të na lëndojnë.

**UJORI**

Konsideroni atë që ju thotë instinkti juaj i pagabueshëm sot. Mund të jetë momenti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.

i pagabueshëm sot. Mund të jetë momenti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.

**PESHQIT**

Sot do ta keni mundësinë të analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitet.

mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitet.


Chyna nuk do t'ia dalë me padinë kundër Kardashianëve



Një pjesë e padisë së Blav Chyna do të hidhet poshtë, pasi një gjykatës ka vlerësuar se nuk është faji i Kardashianëve që ajo ka humbur shoun televiziv. Sipas dokumenteve ligjore, Chyna pretendon se Kris Jenneri dhe vajzat e saj kanë

kërkuar nga "E!" ta ndalojë shoun "Rob & Chyna". Megjithatë, gjykatësi ka vlerësuar se "E!" kishte të drejtë brenda kontratës që të mos e vazhdonte serinë. Chyna mund të ndryshojë padinë në këtë rast, derisa ajo ka ende beteja ligjore me Kardashianët.

The Weekend dhe Bella, së bashku në Kanë



The Weeknd dhe Bella Hadid duket se janë një hap para rregullimit të marrëdhënieve, veçanërisht së fundmi, pasi po shijojnë daljen së bashku. Dyshja janë

parë në jug të Francës, në Kanë, duke dalë nga një ndejë. Kanë kaluar më shumë se një vit qëkur çifti ishin së bashku dhe duket se kanë rinisur lidhjen e tyre romantike.



Tristan Thompsoni flet për herë të parë për vajzën

Tristan Thompson ka folur për herë të parë për ardhjen në jetë të vajzës True Thompson me Khloe Kardashian. Në një intervistë të realizuar për "Road Trippin", Tristan është shprehur tejet i lumtur që është bërë baba për herë të dytë.

"Mendoj që me vajzë jeni shumë me emocional. Me të birin jeni më të qetë, ndërsa me True është pak më ndryshe. Edhe pse është ndjenjë tjetër, është shumë e lezetshme dhe ju bën të ndryshoni", ka thënë Thompsoni.

Akuza për sjellje të pahijshme seksuale në drejtim të R. Kellyt



Këngëtari i famshëm R. Kelly vazhdon të këndojë, por akuzat për sulme seksuale po dëmtojnë gjithnjë e më shumë reputacionin e tij. Ylli i R&B ka

mbajtur të premtën një koncert në Karolinën e Veriut mes akuzave të vazhdueshme për sjellje të pahijshme seksuale, ndërsa karriera e tij është "nën rrethim".

	Autor: GAZMEND MORINA					KËNGËTARI FLORI	SHPREHJE E MENDIMEVE NË NJË VEPËR ARTISTIKE TËRTHORAZI		SHARRRËZ.	ILVA MARE	KAJDE, OJNA	ZANORE	EPOKA ERE	E FRIKËSOJ SHUMË DIKË	METALI I HOLLUAR		QYTET SHQIPTAR NË GREQI TITAN
	SHTAGA												<u>SHTET (FR.) I PAGJAK</u>				
	DIJETAR FETAR MYSLIMAN											AKTORI FRANCEZ DELON (shq.) ZANORE					
	MUHAMET (perkdh.)									AKTORJA FLUTURA SHKRIMTARI ZHITI (shq.)							LIBËR FILLESTAR
	BIMË E VENDEVE TË NGROHTA, ME GJETHE SHUMË TË GJATA											MODELJA ÇUNMULAJ ILION LIKA					
	DETI I YNI										PËREMËR PRONOR				ANITA BITRI KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)		
	KËNGËTARI RAMAZZOTTI										LLOJ VEGLE MUZIKORE TEFIK OSMANI					ZANORE KËNGËTARJA LIBOHOVA	
	ORGAN I FEMRËS SË NJERIUT, GJI (sh.shq.)											VLERË, DOBI (vjet.) UÇK (ang. shk.)					
EPOKA ERE	VEGËL MUZIKORE NË TRAJTËN E NJË QYPI ME FUND TË HAPUR	E PËRZIER; E TRAZUAR	FILLOJ	KUZHINË POPULLORE PRANË XHAMISË	DJALL (hebr.)	<u>ZANORE ALBERTO TOMBA</u>		PJESË E SYRIT	ZHANËR I MUZIKËS QYTET I MADH NË ITALI				KËNGËTARJA GJERMANE KONOR (shqip.) PËRKET, ÇIK (bised.)				
ISH "MISS ALBANIA" KOLA							PËREMËR PRONOR ONTARIO POWER AUTHORITY				LËVIZJA POPULLORE DY BASHKË- TINGËLLORE			<u>SHEGË QYTET I MADH NË GJERMANI</u>			
PUNËTORI I TEATRIT TË KUKULLAVE										GËZIM I MADH KËNGËTARJA MIMANI					<u>NEON SHFUQIZIM</u>		
SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI (sh.shq.)						GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ TENISTI SAFIN						LETRARI MEKULI FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER (MALAGA)					AI QË KËNDON ROK
ALFRED KAÇINARI			KËNGËTARI KRASNIQI FUTBOLLISTI FRANCEZ DIARRA								TEKSTI QË SHËRBEN SI BAZË PËR NJË FILM MJET SHPËRTHYES						
KAFSHË E MADHE QË JETON NË OQEANE							SHPIRTI (Lat.) QELESHJA						<u>NAIM UKA DY ZANORE</u>			<u>OHIO ZANORE</u>	
					RAVENA, PESCARA KËNGËTARI SHAQIRI			E DASHURA E POPAIT PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE						HARK, KTHESË LLOJ VETURE JAPONEZE			
SHPEND GRABITQAR (sh.shq. - fem.) PRODUKT I QUMËSHTIT				FORTESË NDËRTESA E BËRË ME DËRRASA				JONI ME NGARKESË NEGATIVE KËNGËTARJA LIBOHOVA								<u>EVERTON E PESHOVA (bised.)</u>	
EPOKA ERE	SABOTAZHI PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULL- UAR (shq.)									AMERICA ONLINE I AFROVA (bised.)			EMËR YNI MASHKULLI U ARRATISA NGA BURGU				
PUS I UJIT						SHTET I MADH NË AZI (pashq.) REGJISORI I FAMSHËM ... BURTON					LLOJ DRURI FARISHTË				BREJTËS I VOGËL METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT		
MALI MË I LARTË NË TURQI							STADIUM I MADH NË BRAZIL KËNGËTARJA TARNER										SHKRIMTARI SHEHU
BASHKËT.		SKLLAV	... NOKSHIQI GRIMCOVE (bised.)				TEPSI PREJ BALTE (shq.) BOARD ADJUSTMENT ZONING					PADITËSI I SOKRATIT AGIM TEJECI					
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON					SIPËR, KUNDREJT NËN DY BASHKË- TINGËLLORE			REGJISORI ... QOSJA ISMET MUNISHI					AZEM BEJTA	KALIUM, AMPER, ZET DEM, TER			
SHTEGTAR						KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE ZANORE										<u>ZANORE EMPOLI</u>	
LUFTËTARJA ... PALIKUQI				BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA								ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA					

Vizitë në Çernobil, qyteti fantazëm i “Pompeut” Sovjetik

Qyteti ukrainas, skena e fatkeqësisë së vitit 1986, është bërë një atraksion turistik, që këtë vit do të vizitohet nga 65 mijë vizitorë. Është një vend i shkretë që tregon për një katastrofë, utopitë e Bashkimit Sovjetik dhe kontradiktat e sotme

Pranverën e vitit 1986, fëmijët e atëhershëm të shkollave i kujtojnë mirë: paralajmërimet e nënës (“Mos gërmoni në kopsht”); diktati ushqimor (“Mos hani luleshtrydhe dhe marule”), dhe së fundi një frikë paniku për shiun që i nxiti mësuesit të ndalojnë edhe rekreacionin në natyrë. Një re e helmuar që vjen nga Lindja dukej sikur ndoti tokën, të lashtat, madje edhe prodhimin e qumështit. Për gjeneratën që ishte kursyer nga tmerret e Hiroshimës dhe Nagasakit, ishte një edukim atomik në kohë paqeje. Fajtori ishte arratisja gjigante e helmeve radioaktive të krijuara nga shpërthimi i një reaktori bërthamor të energjisë bërthamore: përtej Perdes së

dosur termocentrali, i janë ngrënë pemët, si gjatë letargjisë së Bukuroshes së Fjetur në Pyll. Flenë, në fakt, ndërtesat dhjetëkatëshe, shtëpia e njerëzve fle, hotelet dhe restorantet flenë, pishina fle, fle supermarketi, flenë makinat e ndryshkura e gjithçka. Sepse Prypiat u braktis me vonesë, tri ditë pas shpërthimit, me një eksod masiv të organizuar me nxitim nga Moska. Dhe mbeti i kristalizuar përgjithmonë në një imazh. E neglizhuar dhe e harruar, e shndërruar sot në një lloj Pompei sovjetik, një destinacion turistik paradoksal, megjithatë, në mosinteresimin e përgjithshëm të Kievit, që e kaluara dëshiron absolutisht të harrohet, e mbin-



duke kapërcyer dy pikat e kontrollit dhe duke shkuar përtej ortekëve të dokumenteve burokratike që tregojnë se Ukraina nuk ka ndryshuar shumë në krahasim me Bashkimin Sovjetik.

Banorët e tjerë të këtij qyteti të madh fantazëm, përveç ujqërve dhe arinjve që enden pa zhurmë mes kazermave, janë forcat speciale të ushtrisë ukrainase, siç tregohet nga vrimat e plumbave në dritaret e asaj që ishte bari model i qytetit. Sepse nuk duket e vërtetë, që për snajperët dhe rekreativë, të ketë një terren trajnimi gjigant për të rikrijuar kushtet e përsosura për luftën urbane.

Por përveç pjesës ushtarake, Prypiat është tërheqës për këtë valë të re të turistëve është për shkak se nuk është një vend çfarëdo: në ëndrrat (dhe në broshurat) ortodoksia komuniste u idealizua si Qyteti i së Ardhmes dhe u themelua në vitin 1970, ku çdo sovjetik do të donte të jetonte, siç shkruan sot shkrimi gjigantik dhe i ngadaltë cirilik mbi një nga ndërtesat që flenë. “Fuqia bërthamore gjeneron ushtarë për paqe”. Kjo është arsyeja pse supermarketet në Prypiat duhej të ishin të plota: asgjë, përveç kilometrave të trishtuara kartolinë në Moskë apo

Leningrad! Duke u endur në mesin e karrocave të braktisura dhe raftet e përmbysura, lehtë mund të imagjinosh lumturinë e konsumatorëve të tridhjetë vjetëve më parë për këtë parajsë të rrallë konsumiste. Një lumturi e garantuar nga udhëheqësit e Partisë, të cilët nuk u shqetësuan për të ndërtuar Prypiat vetëm tre kilometra nga reaktori. Dhe këtu është reaktori: sot është varrosur në një sarkofag të madh dhe për asgjësimin e saj ka rreth 4.500 njerëz, të cilët u bënë banorë të rinj, edhe përko-hësisht, të fshatit të afërt dhe të vogël të Çernobilit. Për shkak se një central bërthamor jeton edhe

Nuk ka arsye për t’u frikësuar nga kushtet e së tashmes. Shanset e kthimit të kontaminuar nga udhëtimi në këtë Pompe të Lindjes janë pothuajse zero. Gjatë përumbjes në të gjithë zonën, e cila është 2.600 kilometra katrorë në madhësi, niveli i rrezatimit të perceptuar është më i ulët se ai i një udhëtimi ajror ndërkontinental, me kundërsulm Geiger që luan shumë rrallë në zbulimin e sasive më të larta se normale.

Rreziku, nëse ka ndonjë gjë, është nëntoka ku materialet helmuese janë futur në thellësi: për këtë arsye sot në pyllin e Çernobilit është e ndaluar të gërmohet. Në mes të shkurreve hapet një vend tjetër në këtë udhëtim kujtimi: Çernobili, i quajtur kështu pa imagjinatë, ishte një vend i panjohur në hartat gjeografike, nëse jo tek intelijenca e Ushtrisë së Kuqe dhe KGB-së.

Kishte struktura të mëdha radari, 150 metra të larta, me të cilat Bashkimi Sovjetik donte të kapte sekretet e armikut amerikan gjatë Luftës së Ftohtë. Një punë që ka kushtuar tetë miliardë dollarë dhe në praktikë nuk është përdorur kurrë: dy ditë pas shpërthimit është braktisur me nxitim dhe në mënyrë klandestine.

Këtu atmosfera në Ridley Scott është më e afërt, me kufomat e kompjuterëve në korridoret e



Hekurt midis Lindjes dhe Perëndimit, shumë kohë para rënies së Murit të Berlinit, në Çernobil, Bashkimin Sovjetik.

Në imagjinatën e shtatëvjeçarëve, ishte një univers i largët i mbushur me skenarë apokaliptikë të tymit dhe gërmadhave: nëse na kishin frikësuar aq shumë në oborret e rrethinave tona, kush e di se çfarë duhet të ketë ndodhur atje poshtë, në zemër të katastrofës.

Kështu që fëmijët e sotëm, nuk mund ta imagjinonin se një ditë, në Çernobil, mund të shkonin në një udhëtim, në një vend që nuk ishte më i arritshëm, në një vend – Ukrainë – i lindur nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik. Për të zbuluar atje se ajo që ka mbetur pas 32 vjetësh nga shpërthimi është një djerrinë, por jo si një përrallë futuriste nga Asimov, por më tepër një përrallë zanash post-moderne nga Vëllezërit Grimm. Prypiat, qyteti satelitor prej 50,000 banorësh, ndërtuar tre kilometra larg Çernobilit, fshat shumë i vogël ku ishte ven-

garkuar nga lufta e ngrirë dhe akoma në vazhdim me ish-miq të rusë.

Pavarësisht të gjithave ka plot 65,000 vizitorë që priten për 2018, me një rritje prej 50% krahasuar me 2017. Ju kaloni nëpër punën e palodhur të shoqatave të vogla: për shumën, jo thjesht modeste, prej 150 euro, ju mund të përjetoni tronditje kur të shikoni se si jetohej në BRSS në vitin 1986,



kur vdes, duke pasqyruar kostot sociale që kjo energji ka kur nuk funksionon.

Pastaj ka kosto njerëzore. Të vdekurit, pas shpërthimit në reaktorin numër katër, ishin rreth tridhjetë: ata që punonin në kontakt të drejtpërdrejtë me uzinën. Por sipas studimeve të organeve të ndryshme të pavarura, vdekjet që lidhen me tragjedinë e Çernobilit janë të paktën 800,000, për shkak të tumoreve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga helmet radioaktive: 70% në Bjellorusi, goditën shumë më tepër se në Ukrainë. Ishte era, duke shkuar në veri, që vendosi se ku të mbinte vdekja.

gjata e të errëta dhe kullat e mëdha të harruara të çelikut, të rrethuar nga shenja të sinjalizuara që tregojnë rrezikun e rrezatimit përreth.

Vizita ka përfunduar dhe, ndërsa po largohemi, rritet ndjenja e kalimit nëpër një pjesë të historisë sonë të kohëve të fundit, jo vetëm e mbarsur me katastrofa, por edhe nga utopitë e humbura dhe ëndrrat e porealizuara. Kjo duket se ju kujton një nga Leninët e fundit që ka mbetur në Ukrainë, i cili sot po përpigjet të fshijë të kaluarën e tij, ndërsa, nga sheshi i shkretë i Çernobilit, ai duket i maskuar dhe i hutuar te turistët që largohen. (gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

PARMA - BARI

1

PESCARA - ASCOLI

1

KUBAN - TOM TOMSK

1

Titulli vendoset javën e fundit

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 11 MAJ - Prishtina ka arritur një fitore të madhe ndaj Lirisë dhe në këtë mënyrë e ka shtyrë emrin e kampionit të ri për xhiron e fundit, kur përballët në Pejë me skuadrën e Dritës nga Gjilani. Kjo e fundit të premten e mposhti me rezultat 3-1 skuadrën e Trepçës '89. Fitore ka shënuar edhe Llapi ndaj Flamurtarit (3-1), kurse dy ndeshjet e radhës për këtë xhiro zhvillohen sot (e shtunë) dhe ndeshja e fundit zhvillohet të dielën.

Drita - Trepça '89 3-1

Skuadra e Dritës shënoi fitore para tifozëve të vet në përballje me Trepçën '89, me rezultat 3-1. Vendasit e drejtuar nga Bekim Isufi e nisën keq ndeshjen duke pësuar gol pas pesë minutave lojë. Hajdari pasoi bukur deri të Otto John, i cili e mposhti portierin Rexhepi (0-1). Drita u mundua të rikthehet në lojë në pjesën e parë të ndeshje, por pa sukses. Ndërsa mysafirët në

këtë pjesë e patën edhe një tjetër rast që nuk e konkretizuan në gol. Drita e barazoi rezultatin në minutën e 53-të, kur Ilir Izmaku shënoi autogol. Gjashtë minuta më vonë Astrit Fazliu e solli skuadrën e Dritës në epërsi 2-1. Në minutën e 77-të, Maloku i vendasve bëri një gabim duke ia dhuruar topin Musajt dhe më pas të njëjtin futbollistë e ndali në mënyrë të palejuar në zonën e rreptësisë, kurse gjyqtari kryesor akordoi penallti për Dritën. Nga pika e bardhë i pagabueshëm ishte Fidan Gërbeshi që realizoi për rezultatin final 3-1.

Liria - Prishtina 0-1

Prishtina ka vuajtur shumë në ndeshjen për ta arritur deri të fitorja ndaj Lirisë. Kryeqytetasit e patën dominimin e ndeshjes, sidomos në pjesën e dytë, por golin e fitores e arritën vetëm në kohën shtesë, duke bërë që titulli i kampiones të vendoset në xhiron e fundit. Liria në pjesë e parë pati me shumë raste shënimi, por që të gjitha i shpërdoroi. Në pjesën e dytë



Prishtina e mori kontrollin e lojës dhe krijoi disa rasti shënimi ku e shfrytëzoi vetëm njëherë prej tyre në minutën e 94-të. Kapiteni Armend Dallku harkoi deri të zëvendësuesi Mërgim Pevqeli që realizoi më kokë për 0-1. Në xhiron e fundit Prishtina në Pejë e pret skuadrën e Dritës.

Llapi - Flamurtari 3-1

Fitore para shikuesve të vetë të premten ka shënuar edhe skuadra e Llapit, e cila e mposhti Flamurtarin (3-1). Mirlind Daku e hapi serinë e golave në minutën e 21-të, kurse pas shtatë minutave, i

njëjti futbollist e realizoi edhe golin e dytë për vendasit. Golin e tretë për Llapin e shënoi Mentor Zhdrella nga gjuajtja e lirë, kurse krejt çka arritën mysafirët ishte goli i shënuar nga Samir Sahiti, i cili realizoi nga penalltia në minutën e 78-të. Llapi e qetë e pret xhiron e fundit, kurse Flamurtari do të luajë në barazh për të siguruar mbijetesën.

Sot përballen Gjilani-Drenica dhe Feronikeli-Vëllaznimi

Dy ndeshjet e radhës për xhiron e 32-të në futbollin elitare të Kosovës

zhvillohen sot (e shtunë). Gjilani e pret skuadrën e Drenicës me synim për të arritur fitoren, pasi Vëllaznimi ka dy pikë më pak, dhe pozicionohet në vendin e nëntë që duhet të luajë në barazh për të siguruar mbijetesën. Në anën tjetër edhe Drenica kërkon pikë nga kjo ndeshje mjaftë e rëndësishme. Ndërsa në ndeshjen e dytë që zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, Feronikeli e pret Vëllazninimin e Gjakovës. Të dyja ndeshjet zhvillohen nga ora 16:00, kurse kjo xhiro mbyllet të dielën me ndeshjen në mes Vllaznisë së Pozharanit dhe Besës së Pejës.

Drita dhe Prishtina përfaqësojnë Kosovën në Evropë

Për herë të dytë në Kosovë ka përfunduar licencimi i klubeve që e përfaqësojnë futbollin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Vitin e kaluar Trepça '89 u paraqit në Ligën e Kampionëve, kurse Prishtina në Ligën e Evropës, ndërsa sivjet Drita dhe Prishtina do të bëjnë gara në Evropë

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 12 PRILL - Drita dhe Prishtina do të prezantojnë Kosovën në garat ndërkombëtare të futbollit, pasi ato janë licencuar nga Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), kurse finalistja e Kupës, Vëllaznimi ka dështuar t'i plotësojë kriteret e licencimit. Përveç Dritës dhe Prishtinës janë licencuar edhe Llapi, Gjilani dhe Trepça '89, por asnjëra prej tyre nuk mund të paraqitet në arenën ndërkombëtare për faktin se kanë humbur hapin për titull, kurse janë eliminuar edhe nga Kupa. Në anën tjetër se bashku me Vëllazninimin nuk janë licencuar as dy skuadrat tjera kuqezi: Drenica dhe Flamurtari, kurse katërshen klubeve të palicencuara e kompletin Feronikeli nga Drenasi. Dy skuadrat që tashme e kanë humbur statusin e anëtarit të elitës, Besa dhe Vllaznia e Pozharanit nuk kishin aplikuar fare për licencim. "Këtë edicion prej 12-ve klubeve të Superligës, 10 prej tyre kanë

bëtare për faktin se kanë humbur hapin për titull, kurse janë eliminuar edhe nga Kupa. Në anën tjetër se bashku me Vëllazninimin nuk janë licencuar as dy skuadrat tjera kuqezi: Drenica dhe Flamurtari, kurse katërshen klubeve të palicencuara e kompletin Feronikeli nga Drenasi. Dy skuadrat që tashme e kanë humbur statusin e anëtarit të elitës, Besa dhe Vllaznia e Pozharanit nuk kishin aplikuar fare për licencim. "Këtë edicion prej 12-ve klubeve të Superligës, 10 prej tyre kanë



qenë pjesë e procesit, kurse vetëm dy prej tyre jo. Dy skuadrat të cilat nuk ishin pjesë e këtij procesi janë dy skuadrat të cilat në aspekt sportiv janë larguar në fund të këtij edicioni nga Superliga, Besa dhe Vllaznia. Dhjetë klubet tjera kanë aplikuar të paktën formalisht për të qenë

pjesë e këtij procesi, dhe nga këto dhjetë klube të cilat kanë aplikuar, gjashtë prej tyre kanë pasur një aplikim të suksesshëm që nënkupton komisioni i shkallës së parë ka vendosur që gjashtë prej këtyre klubeve të marrin licencën për garat e UEFA-s 2018-19, kurse katër prej

tyre janë refuzuar dhe kërkojnë që ta marrin licencën për edicionet e radhës", ka thënë menaxheri i licencimit në Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK), Bajram Shala, i cili ka bërë të ditur se krahas këtyre dy klubeve, sot, do të plotësohet edhe forma pararegjistruese në UEFA edhe për klubin Gjilani në kategorinë e juniorëve, që është kampion i Kosovës në Superligën U19, por ende nuk dihet nëse kjo skuadër do të arrijë të marrë pjesë në Youth Champions League, duke pasur parasysh formën se si marrin pjesë klubet në këtë garë. Skuadrat që po luftojnë për titull Drita dhe Prishtina do të prezantojnë Kosovën në garat ndërkombëtare, kurse ka mbetur vetëm të mësohet se cila do të paraqitet në Ligën e Kampionëve e cila në Ligën e Evropës.

Delegacioni i AAU-së: Kosova të formojë sporte të reja

PRISHTINË, 11 MAJ - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, ka prituri në një delegacion të Unionit Amator të Sportit (AAU) nga Iowa e Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Delegacioni kryesohej nga Rusty Buchanan, nënkryetar i parë i AAU-së, Teresa

Parmenter, udhëheqëse e AAU-së në Iowas, Ron Peterson dhe Wes Creason, udhëheqës të Asociacionit të Mundjes në shtetin e IoWas. Bashkë me mysafirët ishin edhe përfaqësuesit e Institutit të Kosovës për Sport, Adnan Ahmeti dhe Flamur Bunjaku. Presidenti Hasani

falënderoi mysafirët për vizitën, derisa i njoftoi për procesin e ndërkombëtarizimit të sportit të Kosovës. "Meqenëse vizita e tyre përkoi edhe me diskriminimin e karateistëve tanë nga qeveria e Serbisë, mysafirët u njohën me vështirësitë që ka pasur prej vitesh sporti i Kosovës nga shteti

fqinj. Buchaman shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në avancimin e sportit të Kosovës, me theks të veçantë sportet në të cilat shtetet amerikane kanë traditë dhe që në Kosovë kanë zhvillim më të ngadaltë. Në lidhje me këtë ata sugjeruan edhe formimin e sporteve të reja,



tek të cilat shtetet amerikane kanë traditë të madhe", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Robbeni dhe Rafinha, edhe një vit te Bayerni

Munchen, 11 maj - Arjen Robben dhe Rafinha do të luajnë me Bayern Munchenin edhe në sezonin e ardhshëm. Drejtori ekzekutiv i Bayern Munichit, Karl-Heinz Rummenigge dhe drejtori sportiv Hasan Salihamidziq, kanë arritur marrëveshje me klubin

"bavarez" dhe sulmuesin 34-vjeçar nga Holanda dhe mbrojtësin 32-vjeçar nga Brazili, që t'i firmosin kontratat e reja deri në 30 qershor 2019. Zyrtarizimi do të ndodhë pas ndeshjes së fundit në kampionatin gjerman, këtë të shtunë

kundër VfB Stuttgartit. Robbeni u bashkua me Bayernin në vitin 2009, kur u largua nga Real Madridi dhe ai ka fituar shtatë herë titullin kampion në Bundesliga dhe pesë herë Kupën e Gjermanisë, gjithashtu edhe trofeun e Ligës së Kampionëve,

me golin e fitores së shënuar prej tij në finalen ndaj Borussia Dortmundit në vitin 2013. Rafinha është pjesë e Bayernit nga viti 2011, ka fituar gjashtë kampionate, tri Kupa të Gjermanisë dhe një Ligë të Kampionëve.



Botërori, pothuajse i humbur për Neuerin

BERLIN, 11 MAJ - U dukë se Manuel Neuer do t'ia dilte të luante të paktën edhe një ndeshje në këtë pjesë të dytë të sezonit me Bayern Munchenin. Portieri mungon që nga tetori i vitit të kaluar dhe iu nënshtrua një operacioni në krah. Vetëm dy ditë më parë ai ishte optimist se do të luante disa minuta përpara se të shkonte në Botëror. Një e drejtë e mohuar nga stafi mjekësor i Bayernit që nuk ia ka rekomanduar Jupp Heynckesit ta aktivizonte portierin në dy ndeshjet e fundit. Me Shtutgartin në kampionat dhe ndaj Frankfurtit në finalen e Kupës së Gjermanisë. Por, shanset janë pakësuar ndjeshëm pas deklarates së Heynckesit: "Manuel Neueri nuk do të luajë në ndeshjen ndaj Shtutgartit për kampionat. Edhe shanset që ai të jetë në finale ndaj Frankfurtit janë shumë minimale, edhe pse duhet të presim edhe disa ditë për të marrë një vendim final". Mbeten vetëm ndeshjet miqësore përpara Botërorit. Ndaj Austrisë më 2 qershor dhe më datë 8 me Arabinë Saudite. Ndeshja e parë në Botëror është më datë 17 qershor kundër Meksikës. Koha nuk është në favorin e tij. Oliver Bierhoff deklaroi javën e kaluar: "Shpresojmë se Manueli



t'ia dalë për të qenë në Rusi. Ai e ka vetë në dorë rikthimin. Ka punuar fort gjatë gjithë këtyre muajve, por i duhet të luajë disa ndeshje përpara se të fillojë turneu. Ne kemi nevojë për atë, pasi është një lojtar i rëndësishëm". Neueri, edhe në rast se do të luante në ndeshjen ndaj Meksikës, do të ishte larg formës së kërkuar. Trajneri Joachim Low nuk mund t'i lejojë vetes të gabojë në zgjedhjen e portierit, pasi në stol ka shumë emra që mund ta zëvendësojnë. Marc

Ter Stegen është kandidati kryesor për të qenë në portë. Edhe pse ndaj Realit, ai pësoi dy gola, bëri një paraqitje shumë të mirë duke treguar një superformë. Në rast të një mungese të Neuerit, Low mund ta rikthejë përsëri Sven Ulreichin si zëvendësues. Edhe pse gabo i në ndeshjen e Ligës së Kampionëve, ai ka treguar një formë shumë të mirë gjatë gjithë sezonit me Bayernin. Botërori është vetëm 36 ditë larg dhe koha po ecën në disfavorin e Manuel Neuerit.

Hamiltoni: Në Barcelonë për fitore

BARCELONË, 11 MAJ - Lewis Hamiltoni përgatitet për betejë këtë fundjavë në Barcelonë, ku do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Spanjës në Formula 1. Pas triumfit dy javë më parë në Baku, piloti spanjoll synon vijueshmërinë edhe në garën e radhës. "Të fitosh në Spanjë pas suksesit në Baku do të ishte fantastike. Unë shpresoj te fitorja. Kemi punuar shumë, ashtu sikurse kemi bërë në çdo garë. E njohim më mirë makinën krahasuar me garat e para, ndërkohë që në Barcelonë kemi bërë teste, ndaj është një pistë që e njohim e mund të paraqitemi mirë", ka thënë Hamiltoni. Piloti britanik i Mercedesit kryeson renditjen e Botërorit të Formula 1, por nuk ka shumë iluzione për sa i përket titullit. "Sezoni është i gjatë,



duhet t'i marrim garat një e nga një, t'i hedhim hapat me kujdes. Unë pres që nga gara e kësaj fundjave në Barcelonë të jemi në harmoni totale me makinën, që do të na jepte mundësi të fito-

jmë. Rivaliteti është i madh, pasi Ferrari do të kërkojë të rikthehet te fitorja, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm dhe t'i shfrytëzojmë situatat", ka deklaruar Hamiltoni.

SHKURT

Vetteli: Titulli? Flasim në tetor

Si asnjëherë më parë në 10 vjetët e fundit te Ferrari është një optimizëm i madh dhe kështu paraqitet edhe në Montmelo skuadra italiane. Gara e parë e Evropës zhvillohet këtë fundjavë në Spanjë dhe 'kokëkuqja' kryeson botërorin për konstruktorë, ndërsa Vetteli është 4 pikë më pak se Hamiltoni. Dy fitoret në garat e Australisë dhe Bahreinit, por edhe paraqitjet në Kinë e Azerbajxhan, kanë treguar se Ferrari i këtij sezoni është ndërtuar në baza të mira dhe ata premtojnë për një kampionat të mirë. Një paraqitje e mirë edhe në Spanjë, pista e testeve dimërore, do të tregonte më shumë besim për italianët. Pas garës në Baku është folur për një keqardhje të pikëve të lëna në dy garat e fundit, por për Vettelin këto janë pjesë të sezonit. "Ka ende shumë gara dhe është e kotë të flasim sot për titullin kampion. Aktualisht luftohet që të arrihet maksimumi në çdo garë dhe kështu do të jetë deri në garën e fundit të sezonit. Ndoshta është më mirë të flasim në një kohë tjetër, kur duhet të kuptojmë më mirë që po luftojmë për titullin. Mund të them se po luftojmë për të fituar dhe në çdo garë do të kërkojmë rezultatet maksimale. Ndoshta në tetor mund të flasim për titullin", ka deklaruar Vetteli.

Iniesta: Griezmanni, i duhur për Barcelonën

Andres Iniesta beson se Antoine Griezmann do të ishte një shtesë e madhe për Barcelonën nëse vendos të kalojë në "Camp Nou" këtë verë. Francezi është përfolur si transferimi më i ri i Barcelonës, pasi katalunasit mendohet se mund ta paguajnë pa problem klauzolën e largimit prej 100 milionë eurosh. Disa medime në Spanjë e kanë bërë të kryer transferimin e francezit në "Camp Nou", duke raportuar se palët kanë arritur tashmë marrëveshje. "Griezmanni do të ishte një nënshkrim i madh, por nuk dua të hyj më thellë, sepse mendja ime ka qenë në gjëra të tjera për dy javët e fundit", ka thënë Iniesta.

16 javë dënim dhe 10 mijë euro për Turanin

Komisioni i Disiplinës i Federatës Turke të Futbollit e ka dënuar Arda Turanin me 16 javë pezullim dhe 10 mijë euro gjobë financiare. Anëtar i Istanbul Basksehir është penalizuar nga Komisioni i Disiplinës me 16 ndeshje pezullim, pasi në ndeshjen me Sivassporin ka shtyrë gjyqtarin anësor, pasi nuk akordoi një faull në dëm të tij. Dhe si të mos mjaftonte, Arda Turan pasi është larguar nga fusha me karton të kuq ka sharë dhe kërcënuar gjyqtarin teksa linte fushën e lojës. Komisioni i Disiplinës ka dhënë penalitetin prej 10 ndeshjesh për shtyrjen e gjyqtarit, 3 për sharje dhe 3 për kërcënimin. Përveç këtij shkualifikimi të gjatë, që hyn në fuqi sezonin e ardhshëm, Turani duhet të paguajë edhe 10 mijë euro gjobë.

Zidane: Japim gjithçka për ta fituar Ligën e Kampionëve

Real Madridi nuk ka pasur një sezon të mirë, duke humbur La Ligën që në dhjetor, ndërsa u eliminua edhe nga Kupa në janar, duke u turpëruar nga Leganes midis "Santiago Bernabeu". Por, trajneri i Los Blancos, Zinedine Zidane, ka thënë se sezonin aspak të mirë në Kupë e Ligë, kanë mundësi ta përmirësojnë me një triumf historik me 26 maj në finale të Ligës së Kampionëve, ku do të përballen me Liverpoolin. "Nuk kemi bërë punë të mirë në Kupë dhe në Ligë, por do të japim gjithçka për Ligën e Kampionëve, të cilën të gjithë duan ta fitojnë. Dy ndeshjet e mbetura në La Liga do të shërbejnë për t'u përgatitur sa më mirë për finalen e Ligës së Kampionëve. Por, duhet të punojmë, mbi të gjitha, me top", ka thënë Zidane.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Infrastruktures- Ministarstvo za Infrastrukturu - Ministry of Infrastructure

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 PërMarrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bën:
Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona Br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, i Zakona Br. 04/L-077 o obligacionim odnosima, u cilju pružanja posebnih usluga, vrši:

**Rishpallje të Konkursit Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
Raspisivanje Javnog konkursa
za Ugovor o posebnim uslugama**

Emri i Institucionit:	Ministria e Infrastruktures Ministarstvo infrastrukture
Njësia Organizative:	Departamenti i Aviacionit Civil Departman Civilne Avijacije
Titulli i punës:	Zyrtar/e për Ndërlidhje me AAC, MPB, ANP dhe KHAIA Službenik/ca za vezu sa ACV-om, MUP-om, MAP-om i KIVNI-om
Numri i referencës:	05-01/2018/MI/DAC/MSHV
Niveli i pagës:	437.55
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të Politikave Zhvillimore Rukovodilac Divizije za razvojne politike
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV) Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Kohëzgjatja e kontratës:	gjashtë (6) muaj Šest (6) meseci
Orari i punës:	I plotë Puno
Numri i ekzekutuesvc:	1 (një) 1 (jedan)
Vendi:	Prishtinë Priština

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Koordinon punët me rastin e procedimit të aplikacionit për licencimin e një operatori ajror kosovar me ç’rast Certifikata e Operatorit Ajror lëshohet nga AAC përderisa Leja e Operimit lëshohet nga MI;
- Informon AAC mbi secilin operator të huaj të licencuar;
- Informon MPB, ANP dhe KHAIA lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e fushëveprimit të tyre.
- Kryen detyrat tjera sipas kërkesave të Drejtorit të Departamentit.

Obaveze i odgovornosti

- Koordinira poslove prilikom obrade aplikacije za licenciranje jednog kosovskog vazduhoplovnog operatora, pri čemu Sertifikat vazduhoplovnog operatora izdaje ACV dok Licencu za rad izdaje MI;
- Informiše ACV o svakom stranom licenciranom operatoru;
- Informiše MUP, MAP i KIVNI o pitanjima koje se odnose na nadležnosti njihovih delokruga;
- Obavlja i druge dužnosti po nalogu direktora Odeljenja.

Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik dhe Ekonomik, apo profil relevant

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska diploma: Pravni fakultet i Ekonomski ili relevantnog smera

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Shkathësitë kompjuterike (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- së paku (1) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.
- Njohja e gjuhës angleze

Sposobnosti, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju:

- Kompjuterske veštine (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- najmanje jedan (1) godine stručnog rada nakon diplomiranja.
- Poznavanje engleskog jezika.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyravedhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077,Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Infrastruktures/Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. A204 kati II, ndërtesa e ish Germise,” Sheshi Nëna Terezë”, Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen www.mi-ks.net

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionine Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 28 547, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **12.05.2018** deri më **19.05.2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet. Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen! Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit. Ministria e Infrastruktures, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Uslovi učesća na konkursu:

Pravo na apliciranje imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji poseduju potpunu poslovnu sposobnosti, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu stručnu spremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje zadataka i koji poseduju fizičke sposobnosti koja se zahtevaju za relevantnu poziciju.

Zakonski i podzakonski akti kojima se reguliše regrutovanje:

Izbor se vrši u skladu sa članom 12. stav 4. Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosovo, Zakona br. 04/L-077, o obligacionim odnosima. Na ovom konkursu sprovodi se pojednostavljena procedura regrutovanja.

Procedure konkurisanja:

Procedura konkurisanja je otvorena za spoljne kandidate.

Podnošenje zahteva:

Preuzimanje i dostavljanje aplikacija: Ministarstvo infrastrukture/Divizija za ljudske resurse, kancelarija br. A204, II. sprat, bivša zgrada Grmije, ”Trg Majka Tereza”, Priština, ili se mogu preuzimati sa internet stranice www.mi-ks.net

Za detaljnije informacije možete kontaktirati Diviziju za ljudske resurse.

Tel. 038 200 28 547, od 8:00 – 16:00 časova.

Konkurs ostaje otvoren 8 kalendarskih dana, od dana objavljivanja, od: **12.05.2018** do **19.05.2018**. godine, koji se smatra poslednjim danom zatvaranja konkursa.

Aplikacije dostavljene putem pošte, koje nose poštanski pečat na pošiljci dostavljene poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se validnim i uzimaće se na razmatranje ukoliko stignu u roku od dva dana; aplikacije koje budu pristigle nakon ovog roka i nepotpune aplikacije, biće odbijene.

Aplikaciji se prilažu kopije dokumentacija za klasifikaciju, iskustvo i ostala neophodna dokumentacija koja se zahteva za mesto, za koje se konkuriše.

Dostavljene aplikacije se ne vraćaju!

Kandidati koji budu izabrani u uži izbor biće pozvani na intervju preko telefona.

Ministarstvo za infrastrukturu pozdravlja aplikacije svih lica, muškog i ženskog roda, svih zajednica.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania KMI Sh.p.k Krivovë, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme në Sankoc komuna e Gllogocit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.06. 2018. në ora 14:00 në hapësinat e objektit të administratës të kompanisë KMI, në Sankoc komuna e Gllogocit do të organizohet debat publik nga Kompania KMI Sh.p.k Krivovë, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme në Sankoc komuna e Gllogocit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Infrastruktures- Ministarstvo za Infrastrukturu - Ministry of Infrastructure

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 PërMarrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bën:
Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona Br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, i Zakona Br. 04/L-077 o obligacionim odnosima, u cilju pružanja posebnih usluga, vrši:

Rishpallje të Konkursit Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
Raspisivanje Javnog konkursa
za Ugovor o posebnim uslugama

Emri i Institucionit:	Ministria e Infrastruktures Ministarstvo infrastrukture
Njësia Organizative:	Departamenti i Aviacionit Civil Departman Civilne Avijacije
Titulli i punës:	Zyrtar/e për strategjitë, politikat e aviacionit civil dhe statistikat Službenik/ca za strategije, politike civilnog vazduhoplovstva i statistike
Numri i referencës:	03-01/2018/MI/DAC/MSHV
Niveli i pagës:	437.55
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të Politikave Zhvillimore Rukovodilac Divizije za razvojne politike
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV) Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Kohëzgjatja e kontratës:	gjashtë (6) muaj Šest (6) meseci
Orari i punës:	I plotë Puno
Numri i ekzekutuesve:	1 (një) 1 (jedan)
Vendi:	Prishtinë Priština

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Koordinon dhe monitoron implementimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Aviacionit në Republikën e Kosovës sipas dinamikave të parapara;
- Është përgjegjës për përhapjen dhe familjarizimin e të gjithë vendimmarrësve në aviacion me këtë Strategji;
- Koordinon me Ministrinë e tjera për çështjet e ndërlidhura dhe të cilat e afektojnë implementimin e mirëfilltë të Strategjisë;
- Ndjek me vëmendje politikat e Bashkimit Evropian mbi transportin ajror si dhe trendët e zhvillimit të aviacionit në BE dhe botë ;
- Mbledhja, procedimi dhe publikimi i statistikave të udhëtarëve dhe kargos në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe kompanitë ajrore Kosovare.
- Kryen detyrat tjera sipas kërkesave të Drejtorit të Departamentit

Obaveze i odgovornosti

- Koordinira i prati sprovođenje Nacionalne strategije za razvoj vazduhoplovstva u Republici Kosovo prema predviđenoj dinamici;
- Odgovoran je za širenje i prihvatanje ove strategije od strane svih donosioca odluka u vazduhoplovstvu;
- Koordinira sa drugim ministarstvima pitanja koja se nadovezuju i koja utiču na pravilno sprovođenje Strategije;
- Pažljivo prati politike Evropske unije o vazдушnom saobraćaju kao i trendove razvoja vazduhoplovstva u EU i svetu;
- Prikupljanje, obrada i objavljivanje statistika putnika i karga na Međunarodnom aerodromu Prištine, i kosovske avio kompanije;
- Obavlja i druge dužnosti po nalogu direktora Odeljenja.

Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik, Ekonomik apo profil relevant

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska diploma: Pravni fakultet i Ekonomski ili relevantnog smera

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Shkathtësitë kompjuterike (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- së paku (1) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.
- Njohja e gjuhës angleze

Sposobnosti, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju:

- Kompjuterske veštine (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- najmanje jedan (1) godine stručnog rada nakon diplomiranja.
- Poznavanje engleskog jezika.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Infrastruktures- Ministarstvo za Infrastrukturu - Ministry of Infrastructure

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 PërMarrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bën:
Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona Br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, i Zakona Br. 04/L-077 o obligacionim odnosima, u cilju pružanja posebnih usluga, vrši:

Rishpallje të Konkursit Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
Raspisivanje Javnog konkursa
za Ugovor o posebnim uslugama

Emri i Institucionit:	Ministria e Infrastruktures Ministarstvo infrastrukture
Njësia Organizative:	Departamenti i Aviacionit Civil Departman Civilne Avijacije
Titulli i punës:	Zyrtar/e për Licencimin dhe Rregullim Ekonomik Službenik/ca za licenciranje i ekonomsko uređenje
Numri i referencës:	04-01/2018/MI/DAC/MSHV
Niveli i pagës:	437.55
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të Licencimeve dhe Rregullimit Ekonomik Rukovodilac Divizije za licenciranje i ekonomsko uređenje
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV) Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Kohëzgjatja e kontratës:	gjashtë (6) muaj Šest (6) meseci
Orari i punës:	I plotë Puno
Numri i ekzekutuesve:	1 (një) 1 (jedan)
Vendi:	Prishtinë Priština

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për implementimin e Rregullores nr 2407/92 të Bashkimit Evropian mbi licencimin e operatorëve ajrorë;
- Bën procedimin e aplikacioneve të operatorëve të interesuar për tu licencuar në Kosovë;
- Mbledh, procedon dhe analizon me përpikëri të dhëna ekonomike mbi operatorin ajror siç janë Biznes Plani, Raportet Financiare, Statuti I Kompanisë, te dhënat mbi aksionaret, bordin e drejtorëve, menaxhmentin e lartë etj;
- Sigurohet që operatori ajror ka qëndrueshmëri financiare që realisht të mund të zhvillojë veprimtarinë e vet ;
- Sigurohet që operatori ajror posedon pulisë të vlefshme sigurie konform Rregullores nr. 785/2004 te Bashkimit Evropian mbi policat e kërkuara të sigurisë për operatorët ajror;
- Sigurohet qe kriteret mbi pronësinë të përcaktuara ne Rregulloren 2407/92 janë respektuar në tërësi;
- Përpilon arsyeshmërinë e rekomandimit apo mos rekomandimit për (mos) lëshimin e Lejes së Operimit një operatori Kosovar. Ky dokument duhet t'i përmbajë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimit nga Ministri, duke përfshirë edhe faktet të marra për bazë kur është vërtetuar (jo)pronësia si dhe(jo) qëndrueshmëria financiare e operatorit ajror Kosovar;
- Është përgjegjës për auditimin e rregullt të performancës financiare të operatorit ajror Kosovar të licencuar;
- Përcjell vazhdimisht ndonjë amandamentim të mundshëm të Rregulloreve te Bashkimit Evropian për implementimin e të cilave është përgjegjës .
- Kryen detyrat tjera sipas kërkesave të Drejtorit të Departamentit.

Obaveze i odgovornosti

- Odgovoran je za sprovođenje Uredbe br. 2407/92 Evropske unije o licenciranju vazduhoplovnih operatora;
- Vrši obradu aplikacija zainteresovanih operatora za licenciranje na Kosovu;
- Prikuplja, obrađuje i analizira precizno ekonomske podatke o vazduhoplovnom operatoru, kao što su: biznis plan, finansijski izveštaji, status kompanije, podaci o akcionarima, upravnom odboru, višem rukovodstvu itd.;
- Osigurava da jedan vazduhoplovni operator ima finansijsku održivost da realno može sprovoditi svoju delatnost;
- Osigurava da vazduhoplovni operator poseduje važeću polisu osiguranja u skladu sa Uredbom br. 785/2004 Evropske unije o zahtevima za police osiguranja za vazduhoplovne operatore;
- Osigurava da su kriterijumi o vlasništvu, koji su utvrđeni Uredbom 2407/92, poštovani u potpunosti;
- Izrađuje obrazloženje za davanje ili odbijanje preporuke za (ne)izdavanje Licence za rad jednom kosovskom operatoru. Ovaj dokument treba da sadrži sve neophodne informacije o donošenju odluke od strane Ministra, uključujući i činjenice uzete kao osnova kada je potvrđeno (ne)vlasništvo kao i finansijska (ne)održivost kosovskog vazduhoplovnog operatora;
- Odgovoran je za redovnu reviziju finansijskog učinka licenciranog kosovskog vazduhoplovnog operatora;
- Neprekidno prati moguće izmene i dopune Uredbi Evropske unije o sprovođenju za koje je odgovoran;
- Obavlja i druge dužnosti po nalogu direktora Odeljenja.

Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik dhe Ekonomik, apo profil relevant

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska diploma: Pravni fakultet i Ekonomski ili relevantnog smera

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Shkathtësitë kompjuterike (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- së paku (1) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.
- Njohja e gjuhës angleze

Sposobnosti, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju:

- Kompjuterske veštine (Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet),
- najmanje jedan (1) godine stručnog rada nakon diplomiranja.
- Poznavanje engleskog jezika.



Sot janë bërë një vit pa më të dashurën tonë

Valbona (Rama) Morina

(21.07.1978 - 12.05.2017)

Ishe ti e vetmja që unë dëgjoj dhe na këshilloje pa më gjykuar asnjëherë. Në ëndrra Valbonë po më vjen shumë rrallë, ndonëse te varri nuk kam mundur me ardhë. Ti nuk më flet, vetëm buzëqesh, floku yt mëndafshit i zbutur, hapi yt i lehtë si flutur, loti yt margaritar, ti ishe melhem për çdo vend.
E kujton me mall: halla Shehria me fëmijët.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 647/18, datë 11.05.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të datës 07.05.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritje të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 618, datë 19.04.2018, për 22 mjekës specialistë të fushave të ndryshme të SHSKUK-së i cili ka zgjatë prej 20.04.2018 e deri më 04.05.2018, vazhdohet edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit,
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në bazë të njoftimit nga Sektori i Personelit në QKUK, se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm që aplikuan në Konkursin publik konform ligjit në fuqi, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së kërkon zbatimin e nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, që Konkursi publik për 22 mjekës specialistë të fushave të ndryshme të SHSKUK-së, të vazhdohet edhe për 15 ditë tjera.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
✓ Zyrës së personelit,
✓ Një mediumit informativ.
✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.Ref. 647/18, data 11.05.2018.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, , članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i Preporuka Komisije za izbor dana 10.05.2018, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

O D L U K A

Za ponavljanje javnog konkursa

- I Javni konkurs br. 618, od 19.04.2018, za 22 specialista iz različitih oblasti UBKSK-a, koji su trajao od 20.04.2018. do 04.05.2018, nastavlja se i dvije nedelje od dana objavljivanja u jednom od medija,
- II. Sektor kadrova je obavezan da izvrši ovu Odluku;
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Na osnovu obaveštenja od Sektora za osoblje u UKCK, da nema dovoljno kandidata koji se prijavljuju za javni konkurs u skladu sa važećim zakonom, Generalni Direktor UBKSK-a zahteva sprovođenje člana 6, tačka 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka javnih Konkursa, da se javni konkurs za 22 stručnjaka iz različitih oblasti UBKSK-a produži još 15 dana.
Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333